

***Si funksionon Serbia në Kosovë?!***

# **STRUKTURAT PARALELE SERBE DHE FUQIZIMI I TYRE NGA UNMIK'u, KFOR'i, EULEX'i DHE QEVERIA E KOSOVES! (1999 - 2011)**



**Shkruan: Sheradin Berisha - Gusht 2011**

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

**- NË VEND TË HYRJES - A U VU NË VERI TË KOSOVËS "RREGULLI NGA KRIZA"?!**

**- KOSOVA NËN ADMINISTRIMIN E OKB'së**

**- STRUKTURAT SERBE TË PASLUFTËS NË KOSOVË!**

**- DOSJET E KRIMINELËVE NË SIRTARËT E KFOR'it!**

**-VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE PARALELE SERBE NË RAPORTET E MISIONEVE TJERA NË KOSOVË,**

**- FUNKSIONIMI I MUP'it DHE I STRUKTURAVE TJERA SERBE NË KOSOVË**

**- FUNKSIONIMI I GJYKATAVE SERBE NË VERI**

**- FUQIZIMI I STRUKTURAVE PARALELE SERBE NGA UNMIK'u DHE QEVERIA E KOSOVËS**

**- MBAJTJA E ZGJEDHJEVE SERBE TË MAJIT 2008 NË SHETËTIN E PAVARUR TË KOSOVËS**

**I.Strukturat paralele të Leposaviqit që dolën nga zgjedhjet e 11 majit 2008**

**II.Strukturat paralele të Zveçanit që dolën nga zgjedhjet e 11 majit 2008**

**III.Strukturat paralele të Zubin Potokut që dolën nga zgjedhjet e 11 majit 2008**

strukturat paralele në veri, përmes Borisllav Stefanoviçit - shëf i delegacionit serb në bisedimet me Prishtinën dhe Goran Bogdanoviçit ministër serb në qeverinë e Serbisë për Kosovën, ndërsa

**3. Faktori i tretë (Sinteza - ndërmjetësuesi i kompromisit)** - ishte KFOR'i në krye me gjeneralin Erhard Buhler, në bashkëveprim me selinë e NATO's në Bruksel, BE'në dhe SHBA'të.



**Borisllav Stefanoviçit - shëf i delegacionit serb në bisedimet me Prishtinën me ushtarin e KFOR'it, në veri të Kosovës - gusht 2011!**

\* \* \*

### **A është vu nën kontroll të Qeverisë-Veriu i Kosovës dhe pikat 1 dhe 31?!**

Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, në të gjitha prezentimet publike ka deklaruar se Veriu i Kosovës tashmë është nën kontroll të plotë të autoriteteve të Prishtinës dhe se është „bllokuar kontrabanda 100 për qind”, “kufijtë janë nën kontroll absolut”, madje krejt në fund (më 18 gusht) deklaroi se kufijtë në veri po i ruajnë „vajzat dhe djemtë e Kosovës“! etj.etj.

A janë të vërteta deklaratimet e kryeministrit?! Jo! Sepse zhvillimet e përditshme në Veri të Kosovës tregojnë se atje funksionojnë edhe me të organizuar **Strukturat paralele me gjithë infrastrukturën e shërbimeve sekrete serbe (MUP, BIA, KOS..)** dhe strukturat pushtetore (**Ministria për Kosovën dhe Metohinë**) dhe ato publike (**Posta dhe telekomi serb, mediat, arsimi, shëndetësia, kultura, teatri, sporti etj. etj.**)

**IV. Strukturat paralele në Mitrovicën Veriore që dolën nga zgjedhjet e 30 Majit 2010**  
**- FUNKSIONIMI I QEVERISË SERBE NË KOSOVË PËRMES MINISTRISË PËR KOSOVË DHE METOHI - STRUKTURA E PUSHTETIT SERB NË KOSOVË**  
**- FUNKSIONIMI I INFRASTRUKTURËS PUBLIKE SERBE NË KOSOVË**  
**I. Funkionimi i Odës Ekonomike të Kosovës dhe Metohisë**  
**II. Funkionimi i Elektro&Kosmet'it, Postës dhe Telekomit të Serbisë!**  
**III. Funkionimi i të gjitha niveleve të arsimit serbë në Kosovë**  
**IV. Funkionimi i sistemit shëndetësor serbë në Kosovë!**  
**V. Funkionimi i institucioneve serbe të kulturës dhe sportit**  
**VI. Funkionimi i radiove serbe në Kosovë!**  
**- SHTOJCË -**  
**KOMUNAT E REJA SERBE DHE TRASHËGIMIA KULTURORE DHE FETARE SERBE SIPAS PAKOS SË AHTISAARIT**

## **NË VEND TË HYRJES**

### **A U VU NË VERI TË KOSOVËS "RREGULLI NGA KRIZA"?!**

Në shkrimin "Trupat e KFOR'it "dorëzohen" përballë bandave kriminale në Veri" të publikuar më 30. 07. 2011 - 23:30 min. kam thënë: "Në këtë situatë të nderë, duket se gjenerali Buhler ka marrë rolin e ndërmjetësuesit për uljen e tensioneve në teren dhe rrjedhimisht po e përgatit opinionin, që çështja e veriut (dhe pikat kufitare 1 dhe 31), të hidhen në tryezën e bisedimeve Prishtinë - Beograd për zgjidhje." Dhe, nga data 25 korrik e gjer më 5 gusht u dëshmuar qartë se gjenerali Buhler ishte ndërmjetësuesi kryesor për arritjen e një marrëveshjeje kalimtare (prej 10 pikash), e cila do të mundësonte uljen e tensioneve në teren, dhe pastaj çështja e veriut të shtrohet për zgjidhje në tryezën e bisedimeve, që pritet të vazhdojnë më 2 shtator në Bruksel.



**Borisllav Stefanoviqi dhe gjenerali Buhler i KFOR'it, gjate ndermjetesimit**

## per uljen e tensioneve ne veri te Kosoves!

\* \* \*

Dihet mirëfilli se në ekonomi çdo ecuri zhvillimore planifikohet, prandaj edhe në politik ngjarjet e mëdha që bëjnë kthesa në zhvillimet e një procesi politik planifikohen. Në filozofinë politike kushtuar krizave politike sipërfaqësohen parimet: „rregull nga shkaktimi i krizave“, dhe „fitore përmes konfliktit“, të cilat vijëzohen plotësisht në doktrinën dialektike: „Teza, antiteza dhe sinteza“ të filozofit gjerman **Georg Fridrih Vilhelm Hegel (1770 - 1831)**. Pra, sipas këtyre parimeve për të ndryshuar një gjendje politike kërkohet shkaktimi i një krize dhe kjo krizë pastaja eskalon dhe zhvillohet nën menaxhimin dhe kontrollin e faktorëve politik etj., plotësisht sipas doktrinës hegeliane „teza - antiteza - sinteza“. Duket se Hegeli ka identifikuar procesin universal me anë të të cilit të kundërtat, të cilat ai i quante „tezë“ dhe „antitezë“, bashkohen gjithnjë në një kompromis të nivelit më të lartë, që quhet „sintezë“! Kjo dialektikë hegeliane, për fat të keq është provuar të jetë e përdorur gjatë shek.XX nga politikbërësit e pamëshirshëm për manipulimin e ngjarjeve në dobi të agjendës së tyre! Në këtë kuadër, duket qartazi se të gjitha krizat e pasluftës në Kosovë dhe me theks të veçantë kriza e krijuar në veri të Kosovës po zhvillohet mbi bazën e agjendave të përcaktuara nga faktorë të jashtëm që i përkasin prapaskenës politikbërëse!

### **Po përpiqem ta shpjegoj krizën në veri mbi këtë bazë:**

**1. Faktori i parë:** Qeveria e Kosovës për të vënë rregull - (rend kushtetues në veri të Kosovës dhe në pikën 1 dhe 31) në mbrëmjen e 25 korrikut 2011 urdhëron Njësinë Speciale të Policisë së Kosovës (ROSU) për të marrë nën kontroll pikat doganore 1 dhe 31, nga që ishin ato të vetmet pika kufitare ku nuk po zbatohej vendimi i Qeverisë për të ndaluar mallrat që hynin me vulë të doganave të Serbisë.

**2. Faktori i dytë:** Pas këtij intervenimi policorë, reagon Beogradi përmes strukturave paralele të organizuara në veri të Kosovës me bllokimin e dy rrugëve kryesore që të çojnë në pikat kufitare 1 dhe 31.

**3. Faktori i tretë:** Në këtë eskalim të situatës faktori i tretë ishte KFOR'i në krye me gjeneralin gjerman Erhard Buhler dhe faktorë të tjerë diplomatik në Prishtinë, në Bruksel dhe Washington.

Gjatë ditëve të krizës ishte gjenerali Buhler, ai që e kishte nën kontroll situatën e krijuar dhe mbante kontakte me Hashim Thaçin dhe Borisllav Stefanoviçin dhe me ndërmjetësimin e tij, më 5 gusht u arrit një marrëveshje tripalëshe (e përkohshme gjer më 15 shtator) me qëllim të uljes së tensioneve dhe normalizimit të gjendjes, në mënyrë që Prishtina dhe Beogradi pas një kohe përmes dialogut të arrijnë marrëveshje afatgjate politike - e jo teknike, siç po manipulojnë të gjithë faktorët politikë!

### **Kush ishte në këtë rast: Teza, antitza dhe sinteza?!**

**1. Faktori i parë, (Teza - vënësi i rendit të ri)** ishte Qeveria e Kosovës me Hashim Thaçin dhe Bajram Rexhepin,

**2. Faktori i dytë, (Antiteza - kundërshtuesi i rendit të ri)** ishte Serbia me



Gjenerali Buhler me Kryemistrin Hashim Thaci, me 5 gusht 2011...

Pa demilitarizimin, shpërbërjen dhe arrestimin e bartësve të këtyre strukturave serbe që veprojnë në Kosovë, nuk mund të thotë askush, as KFOR'i - as qeveria e Kosovës..., se ka vu kontroll të plotë dhe rend kushtetues në këtë pjesë të Kosovës. Ndonëse kufijtë - (pikat 1 dhe 31), janë shpallur si „zona ushtarake“ ato nuk kontrollohen nga „**vajzat dhe djemtë**“ e Kosovës, siç gënjen paturpshëm kryeministri Thaçi, por nga „vajzat dhe djemtë“ e KFOR'it. Kontrabanda nuk është ndalur, madje ajo vazhdon të funksionojë fuqishëm nga rrjeti i gjerë mafioz (duke u përfshirë këtu edhe shqiptarët), dhe ata veprojnë pa u penguar tashmë 12 vjet pas përfundimit të luftës. Nga kjo gjendje duket se deklaratat e kryeministrit nuk mund të konsiderohen ndryshe veçse Propagand, që tashmë ka filluar t'i dalë boja!

Dihet mirëfilli se krijimi i dilemave e mjegullnajave në mendjen e njerëzve bëhet pikërisht nga propaganda. Në vitin 1928, **Uollter Bernejs** ka botuar një libër me titull: „**Propaganda**“. Uollter, shpjegon gjerësisht se si manipulohet dhe kontrollohet mendja e njeriut. „**Ata që manipulojnë me shoqërinë përbëjnë një qeveri të padukshme e cila është fuqia e vërtet sunduese... dhe në këtë kontekst mendjet tona modelohen, shijet tona trajtësohen dhe ideat tona sugjerohen.**“ ka shkruar Bernejsi.

Në rastin tonë, ata që manipulojnë me shoqërinë e Kosovës janë faktorë të jashtëm, (si qeveri e padukshme), përmes qeverisë së Kosovës si qeveri e dukshme - publike, dhe prandaj „fuqia e vërtet sunduese“ është „**qeveria e padukshme**“, për faktin, sepse ata hartojnë **agjenda politike e zhvillimore etj., që janë në harmoni të plotë me interesat e tyre afatgjate, e të cilat realizohen nëpërmjet qeverisë së dukshme.** Për të konkretizuar këtë fakt, kujtoni idenë, përgatitjet dhe caktimin e agjendës së bisedimeve të ashtuquajtura „teknike - praktike“ që po zhvillohen ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel. **E kujt ishte ideja dhe e gjithë agjenda e këtyre bisedimeve?! A ishte kjo ide e Kosovës? Përgjigjja është Jo, nuk ishte! Ajo ishte ide e fuqisë së vërtet sunduese, e OKB'së, BE'së dhe SHBA've.** Tashmë është e qartë se, „qeveria e padukshme“, është fuqia

ekzekutive - qeverisëse në Kosovë, ndërsa qeveria e dukshme e Kosovës është refleksion i kësaj fuqije! Kjo është e vërteta, të tjerat janë propagandë!

## KOSOVA NËN ADMINISTRIMIN E OKB'së

Dihet mirëfilli se, statusi politik i Kosovës me **Rezolutën 1244**, të Këshillit të Sigurimit (që u miratua më 10 qershor 1999), u përcaktua si protektorat i **OKB'së**. Sipas kësaj rezolute OKB'ja me Misionin e saj të quajtur UNMIK (**United Nation Mission in Kosovo**) mori përgjegjësinë për administrimin civil të Kosovës, që udhëhiqej nga "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara - PSSP" (Shikoni këtu: **hartën e shtrirjes së UNMIK'ut**), ndërsa NATO me trupat e saj të quajtur **KFOR** (sipas marrëveshjes tekniko'ushtarake të Kumanovës NATO'AJ -**Military Technical Agreement** të datës 9 qershor 1999) mori përgjegjësinë e sigurisë. Kur u miratua kjo rezolutë sekretar gjeneral i OKB'së ishte **Kofi Annan** nga **Gana**. Edhe pse rezoluta e bënë Kosovën protektorat të OKB'së, aty disa herë theksohet se Kosova është pjesë e Jugosllavisë !!! (Lexoni me kujdes **rezolutën 1244** - [http://wikisource.org/wiki/Rezoluta\\_1244](http://wikisource.org/wiki/Rezoluta_1244) edhe këtu: **United Nations Security Council Resolution 1244** - [http://en.wikipedia.org/wiki/United\\_Nations\\_Security\\_Council\\_Resolution\\_1244](http://en.wikipedia.org/wiki/United_Nations_Security_Council_Resolution_1244)) Edhe NATO (KFOR'i) sipas marrëveshjes së Kumanovës, Kosovën e konsideronte si Provincë Autonome të Serbisë (Shikoni hartën: "**Kosovo force sectors (KFOR) Serbia - Kosovo Autonomous Province - May 2002**" [http://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/4/40/KFOR\\_Sectors\\_2002.jpg](http://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/4/40/KFOR_Sectors_2002.jpg) - për më tepër lexoni marrëveshjen NATO'AJ në formatin tjetër **Military Technical Agreement** - <http://www.serendipity.li/nato/mta.htm>).

**Ku ishin komandantët e KFOR'it 1999 - 2011?**

12 Jun 1999	8 Oct 1999	Sir Michael Jackson (U.K.)
8 Oct 1999	18 Apr 2000	Klaus Reinhardt (Germany)
18 Apr 2000	16 Oct 2000	Juan Ortuño Such (Spain)
16 Oct 2000	6 Apr 2001	Carlo Cabigiosu (Italy)
6 Apr 2001	3 Oct 2001	Thorsten Skiaker (Norway)
3 Oct 2001	4 Oct 2002	Marcel M. Valentin (France)
4 Oct 2002	5 Oct 2003	Fabio Minni (Italy)
5 Oct 2003	1 Sep 2004	Holger Kammerhorf (Germany)
1 Sep 2004	1 Sep 2005	Yves de Kermabon (France)
1 Sep 2005	1 Sep 2006	Giuseppe Valotto (Italy)
1 Sep 2006	31 Aug 2007	Roland Kather (Germany)
31 Aug 2007	29 Aug 2008	Xavier Bout de Marnhac (France)
29 Aug 2008	8 Sep 2009	Giuseppe Emilio Gay (Italy)
8 Sep 2009	1 Sep 2010	Markus J. Bentler (Germany)
1 Sep 2010	1 Sep 2011	Erhard Bühler (Germany)


Kush ishin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP) në periudhën 1999 - 2011 në Kosovë?		
13 Jun 1999	15 Jul 1999	Sérgio Vieira de Mello (Brazil) (acting)
15 Jul 1999	15 Jan 2001	Bernard Kouchner (France)
15 Jan 2001	31 Dec 2001	Hans Hækkerup (Denmark)
1 Jan 2002	14 Feb 2002	Charles H. Brayshaw (U.S.) (acting)
14 Feb 2002	8 Jul 2003	Michael Steiner (Germany)
8 Jul 2003	25 Aug 2003	Charles H. Brayshaw (U.S.) (acting)
25 Aug 2003	11 Jun 2004	Harri Holkeri (Finland)
11 Jun 2004	16 Aug 2004	Charles H. Brayshaw (U.S.) (acting)
16 Aug 2004	30 Jun 2006	Søren Jessen Petersen (Denmark)
30 Jun 2006	31 Aug 2006	Steven Paul Schook (U.S.)(acting)
1 Sep 2006	20 Jun 2008	Joachim Rücker (Germany)
20 Jun 2008	1 Jul 2011	Lamberto Zannier
1 Jul 2011	....	Robert E. Sorenson (U.S.)(acting)

(<http://www.portalestoria.net/KOSOVA.htm>)

## STRUKTURAT SERBE TË PASLUFTËS NË KOSOVË!

Prania e shtetit serb në Kosovë nuk ka pushuar së ekzistuari as pas qershorit 1999 kur Kosova u vu nën protektoratin e OKB'së. Përderisa para luftës Serbia në Kosovë ishte e pranishme me administratën dhe forcat ushtarake policore të kryekriminelit Millosheviq, pas qershorit të vitit 1999 ajo do të jetë e pranishme nëpërmjet strukturave të saja paralele. Pra, rrjedhimisht prania e shtetit serb në Kosovë nuk ka pushuar për asnjë çast, ajo vetëm se, e ka ndërruar formën e veprimit. Në vitin 2000, pas ndërrimit të pushtetit në Serbi, qeveritarët e rinj të Beogradit trashëguan gjithë infrastrukturën kriminale të Milosheviqit në Mitrovicën Veriore, në Leposaviç, Zubin Potok dhe në Zveçan. Nën maskën e të ashtuquajturës "Qendra për paqe dhe tolerancë", në këtë pjesë të pushtuar të Kosovës u shfaqën fillimisht "Rojat e urës" në krye me Oliver Ivanoviçin, Marko Jakshiqin, Spasoje Memaroviç etj. Kjo strukturë kriminale përbëhej edhe nga „tigrat“ e kriminelit Zhelko Razhnjatoviç - Arkan, nga pjesëtarë të Partisë Radikale - çetnike të Sheshelit, agjentë të Shërbimit Informativ Serb (BIA), pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP) etj.


**(Shikoni: Hartën e komunave të Kosovës. Veriut i Kosovës me ngjyrë portokalli dhe Lumi Ibër që ndanë qytetin e Mitrovicës në dy pjesë!**



**Shikoni hartën Përbërja etnike e Kosovës në vitin 2005 - sipas OSBE'së )**



## Ethnic composition of Kosovo (2005)



Kryeadministratori i parë i UNMIK'ut Bernard Kushner, në librin e tij „Luftëtarët e paqes“ gjendjen në Mitrovicë dhe organizimin e formacionit „Rojat e Urës“, e përshkruan si vijon: "Kolonat franceze, të ngarkuara për këtë zonë (në Mitrovicë... - Sh.B) gjatë futjes së aleatëve, më 12 qershor 1999, duke vendosur fushimin në jug të qytetit, nuk e ndoqën policinë e Beogradit, por u ndalën në urë, duke futur rrallazi ndonjë njësit të vëzhgimit më në veri, ku zbuluan pjestarë të policisë dhe të vrasësve që bartin skalpet dhe flokë grashë shqiptare të varura në hallkat e rripit. Me urdhër të kujt ishin ndalur (te ura) forcat tona çlirimtare? Kurrë nuk kam mundur ta mësoja saktësisht, por ky ishte një gabim i madh politik. Ky ndalim i papritur, jo vetëm bëri nga Mitrovica një qytet të ndarë, por shkaktoi një eksod masiv, një ndjekje reciproke e të përhershme të refugjatëve të nemitur e të privuar nga të gjitha, dhe u ofroi serbëve një territor strehimi të papritur, në kufi me Serbinë që ende drejtohej nga Milosheviqi. Shumë shpejt vullnetarët serbë organizuan në veri të Urës një polici të udhëhequr me mjeshtëri nga Oliver Ivanoviqi, sportist i mëhershëm profesionist. Ai si njeri i guximshëm politik që ishte, u bë për UNMIK'un një bashkëbisedues i vështirë, dhe po aq i sigurtë sa mund të jetë njeriu në ato rrethana. Ai organizoi një njësit të armatosur të bridge watchers, rojat e urës, njerëz të armatosur të të gjitha tendencave, që nga njerëzit më të ndyrë e më brutalë deri te patriotët më të

devotshëm, të cilët e kishin shtabin e tyre në "Dolce vita", përballë Urës, ku shenjuan "territorin e lirë serb", e të cilët nëpërmjet komunikimit me radiolidhje, mund të mblidheshin me alarmin e parë. Ne u përpoqëm t'i zhvendosim disa herë, por kot...komandanti francez i zonës (gjeneralit Pierre de Saqui de Sannes) ishte kundër lëvizjeve tona që rrezikonin autonominë serbe në pjesën e epërme të qytetit të Mitrovicës." (Për më tepër lexoni librin: *Bernard Kushner „Luftëtarët e paqes, Grasset, Paris, 2004*) Pra, siç duket KFOR'i i ka toleruar këto struktura kriminale dhe forcën e ka përdorur në ato përmasa sa për ta ruajtur “një ambient të qetë dhe të sigurtë” në dukje!!!



- Shefi i “Rojave të urës” Oliver Ivanoviç -



- Kriminelët Marko Jakshiq dhe Milan Ivanoviq -

## DOSJET E KRIMINELËVE NË SIRTARËT E KFOR'it

Se trupat e KFOR'it janë përpjekur të ruajnë “një ambient të qetë dhe të sigurtë” sa për dukje, duke i lënë të lirë kriminelët, flet edhe një dokument konfidencial i KFOR'it, i hartuar qysh në vitet 2001 - 2002, në të cilin përshkruhet veprimtaria e mbi 400 kriminelëve që veprojnë në Kosovën veriore, si të kriminelëve: Milan Ivanoviq, Oliver Ivanoviq, Marko Jakshiq, Spasoje Memaroviq - ECHO etj.


NATO CONFIDENTIAL

Réfêrence BIM <b>KOS</b> 213	<u>FICHE BIOGRAPHIQUE</u>	Mise à jour le: 03.09.01
<p><b><u>IDENTITE</u></b></p> <p><b>NOM:</b> IVANOVIC</p> <p><b>Prénom:</b> Milan</p> <p><b>Date de naissance:</b> 05.02.1955</p> <p><b>Lieu de naissance:</b></p> <p><b>N° Carte d'identité:</b></p>		

**Milan Ivanoviqi (05. 02. 1955)**

Dokumenti konfidencial i KFOR'it (pjesë të së cilit janë bërë publike këto ditë), **Milan Ivanoviqin** e përshkruan si një kriminel të vërtetë, i cili e ka nën kontroll tërë veriun e Kosovës. Në dosje shkruan se ky njeri ka „karakter ksenofobik, që kontrollon të gjitha karburantet në veri, kontrabandën me ilaçe

dhe materialet ndërtimore,...“Ai i vjelë tarifat prej njëmijë markash gjermane (atëherë ishte kjo monedhë në qarkullim) për një kamion që të kalojë nëpër veriun e Kosovës”. Milan Ivanoviqin, cilësohet si “Kryetar i Komitetit të Mbrojtjes së Kosovës Veriore dhe Kryetar i Këshillit Nacional Serb” dhe duke patur këto poste politike ai ka luajtur me kartën më radikale si “boss” i të gjitha zhvillimeve kriminale në veriun e Kosovës.

<b>KOS</b>	NATO CONFIDENTIAL	Mise à jour le : 03.09.01
<b><u>FICHE BIOGRAPHIQUE</u></b>		
<b><u>IDENTITE</u></b>		
<b><u>NOM</u></b> :	JAKSIC	
<b><u>Prénom</u></b> :	MARKO	
<b><u>urnom</u></b> :		
<b><u>Date de naissance</u></b> :	04/11/1951	
<b><u>Lieu de naissance</u></b> :	ZUBIN POTOK	
<b><u>Pièce d'identité</u></b> :		
<b><u>Adresse</u></b> :		
ZUBIN POTOK le week-end (DN 74-51), possède un appartement à <b>Marko Jakshiq (04. 11. 1951)</b>		

Në dokumentin konfidencial të NATO's, **Marko Jakshiq** (me profesion mjek - ortoped) është një tjetër figurë serbe, i përshkruar si kriminel e lider politik i serbëve në veri të Kosovës dhe anëtar i Partisë Demokratike të Serbisë (DSS). Jakshiq përshkruhet si një person jashtëzakonisht armiqësor dhe tejet i ashpër për të gjithë ata që ndërhyjnë në KOS. Në pjesën e dytë të vitit 1999 (pas përfundimit të luftës), Marko Jakshiq ka qenë shumë i ashpër - thuhet në dokumentin e NATO'së. Ai ka refuzuar në mënyrën më brutale dhe të pakompromis kthimin e mjekëve dhe të pacientëve shqiptarë në spitalin në veri të Mitrovicës. Në mars të vitit 2000, Jakshiq ka organizuar serbët e veriut kundër KFOR'it, UNMIK'ut dhe institucioneve të Kosovës, duke u thënë se ata po duan t'i kthejnë shqiptarët në veri të Mitrovicës, kurse, sipas tij, “nuk po bëjnë asgjë për kthimin e serbëve në Pejë, Prishtinë, Ferizaj“etj. Marko Jakshiq, sipas dokumentit, ka ushqyer nacionalizmin e shfrenuar serb në veri dhe ka qenë pjesë e rrjetit të krimit të organizuar në atë pjesë të Kosovës, duke synuar përherë bashkimin e veriut të Kosovës me Serbinë, dhe të gjitha këto veprime i ka bërë në koordinim të plotë me Beogradin dhe me strukturat tjera kriminale serbe në veri të Kosovës. Në aktivitetin e tij kriminal në veri të Kosovës, Marko Jakshiq përmendet si anëtar i Komitetit Politik për Mbrojtjen e të Mitrovicës - CPDM, në të cilin merrnin pjesë edhe kapo'bandat Milan Ivanoviq, Dragan Gjakoviq, Vukomir Antonijeviq e kriminelë të tjerë të veriut të Mitrovicës. Marko Jakshiq, bashkë me Milan Ivanoviqin, sipas dokumentit të NATO's, kanë organizuar edhe mbrojtjen territoriale me serbë në veri të Kosovës, dhe mbrojtjen e Urës së

Ibrit, duke vendosur barrikada dhe duke synuar pengimin e aktivitetit të UNMIK'ut e të KFOR'it në atë pjesë. Së fundmi, përmes të të ashtuquajturit Këshill Nacional Serb, formoi "Parlamentin Serb të Veriut", i mbështetur nga i ashtuquajturi drejtor i Trepçës, Ivan Dimkiq. Në maj të vitit 2001, në dokumentin konfidencial të NATO's thuhet se, Marko Jakshiq, bashkë me kriminelë të tjerë, si Milan Ivanoviq, Momçillo Trajkoviq dhe Vuko Antonijeviq, bënë pjesë në mesin e trafikantëve dhe shantazhuesve më të mëdhenj të tregtisë së zezë me karburante në veri të Kosovës. Përmes këtyre parave të pista, ata në vazhdimësi i financuan edhe të ashtuquajturit "Roja të Urës".

<b>KOS</b>	<b>NATO CONFIDENTIAL</b>	Mise à jour le : 12.11.01
<b><u>FICHE BIOGRAPHIQUE</u></b>		
<b><u>IDENTITE</u></b>		
<i>NOM</i> : IVANOVIC		
<i>Prénom</i> : Oliver		
<i>Date de naissance</i> : 01.04.53 à RZNIC (MONTENEGRO)		
<i>Fonction actuelle</i> : porte-parole SNV		
<i>Adresse</i> 184 rue KRIAA (PIERRE I de Serbie) de MITROVICA Immeuble L8 sur Passy entrée 79, 4 <sup>e</sup> étage, appt. 15 Bureau : local dénommé la "maison blanche", 8887/4890, tel 30 130 ou 30 131 ou 471758		
<b>Oliver Ivanoviq (01. 04. 1953)</b>		




Në dokumentin konfidencial të NATO's, **Oliver Ivanoviq** (Ekonomist me profesion dhe karateist me hobi), cilësohet, gjithashtu, si një prej figurave kyçe të serbëve në veri të Kosovës. Në dokument sipërfaqësohen disa veprime të Oliver Ivanoviqit, të kryera para dhe gjatë luftës në Kosovë. Ai, (para luftës) si anëtar i SPS'it të Millosheviqit, është shquar në fushatën për largimin e shqiptarëve nga puna, në Mitrovicë, dhe për diferencimin e tyre nga të gjitha organizatat sportive, në krye të cilave kishte ardhur me direktiva të pushtetit në Beograd dhe ishte mandatuar me këtë mision. Për një kohë të shkurtër, Oliver Ivanoviqi e kishte spastruar Mitrovicën nga shqiptarët me përgjegjësi, në organizatat punuese dhe në ato sportive, në fillim të viteve '90. Ndërkaq në fund të viteve '90, Oliver Ivanoviqi përmendet si pjesë e një grupi paramilitar serb, në shërbim të plotë të krimeve të bëra me strategji në Kosovë, nga regjimi i Millosheviqit. Para luftës, sipas këtij dokumenti, Oliver Ivanoviq, në palestrën sportive të Mitrovicës iu kishte shpërndarë armë serbëve, kurse kishte bërë plane për shfarosjen e shqiptarëve në lokalit "Kafana", në Zveçan. Bashkë me një vëlla të tij, ai kishte hartuar një listë për likuidimin e intelektualëve dhe civilëve të tjerë shqiptarë në veri të Kosovës. Dokumenti konfidencial i NATO'së e bën atë përgjegjës edhe për vrasjen e 26 shqiptarëve, gjatë kohës së luftës, në veri të

Kosovës. Nën „llupën“ e NATO’s zbardhet edhe një cilësi tjetër e karakterit të Oliver Ivanoviqit, ajo e profiterit. I gjetur ngushtë nga rezistenca e madhe e Milan Ivanoviqit brenda të të ashtuquajturit Këshilli Nacional Serb i Veriut, Oliver Ivanoviqi ndërron kartën e politikës, bëhet më liberal. Bashkë me Rada Trajkoviqin dhe disa të tjerë ai vendosë të bëhet pjesë e institucioneve të Kosovës. Insiston që serbët të marrin pjesë në zgjedhjet e 17 nëntorit 2001, dhe ai bëhet deputet i Parlamentit të Kosovës (nën administrimin e UNMIK’ut), me kuotën e rezervuar për pakicat. Për dallim prej Milan Ivanoviqit, që luante me kartën radikale, Oliver Ivanoviqi, filloi të luaj me kartën liberale. Por, qëllimi ishte i njëjtë: menaxhimi i milionave. Në kaosin e krijuar në veri të vendit, Oliveri i menaxhonte milionat e projekteve për pakicën serbe, (në emër të kthimit të serbëve të zhvendosur) që vinin nga bashkësia ndërkombëtare. Dhe pa dyshim se, kjo u arrit vetëm përmes partneritetit të krijuar me KFOR’in dhe UNMIK’un, që ishin përgjegjës për administrimin civil dhe të sigurisë në Kosovë.

<b>KOS</b>	NATO CONFIDENTIAL	Mise à jour le : 02.09.01
<b><u>FICHE BIOGRAPHIQUE</u></b>		
<b><u>IDENTITE</u></b>		
<b><u>NOM</u></b> :	RISTIC	
<b><u>Prénom</u></b> :	SLAVISA	
<b><u>surnom</u></b> :		
<b><u>Date de naissance</u></b> :	01/01/1960	
<b><u>Lieu de naissance</u></b> :		
<b><u>Pièce d'identité</u></b> :		
<b><u>Adresse</u></b> :	maison à ZUPCE en (DN803-504). C'est une maison isolée à l'est de PRELEZ (DN 80-50). Le champ à proximité de sa maison est cultivé par des KOA	
<b><u>Tel</u></b> :	24 741	
<b>Slavisha Ristic (01.01.1960)</b>		

Në dokumentin e KFOR’it është një dosje edhe për “nacionalistin e moderuar” **Slavisha Ristic (1960)**. Ristic është përfaqësues i Partisë Demokratike të Serbisë së Vojislav Koshtunicës, i ashtuquajtur kryetar i Komunës së Zubin Potokut, dhe njëherit përfaqësues i Këshillit Nacional Serb në këtë komunë. Me profesion është ekonomist, në pranverën e vitit 2001 ai u emërua kryetar i Nënkomitetit për kthimin e refugjatëve serbë në Kosovë. Ristic në dosjen e KFOR’it pasqyrohet si një militant i “kauzës serbe”, por me “tone më të moderuara”. Pas luftës në Kosovë kishte kërkuar me ngulm nga bashkësia ndërkombëtare, “kthimin e të zhvendosurve serbë në Kosovë, ashtu siç i kanë kthyer edhe shqiptarët”. Çështjet e veriut të Kosovës, Ristic i ka diskutuar me Beogradin, ashtu si dhe të gjithë drejtuesit tjerë politikë të serbëve të veriut. Ai, në janar të vitit 2001, ka biseduar në Beograd, me V.Koshtunicën, që është nga

partia tij, për temën e Kombinatis "Trepça" dhe kthimin e serbëve në veri të Kosovës. Bashkë me Sllavisha Ristiçin, në takim kanë qenë edhe Marko Jakshiq dhe Vuko Antonijeviq. thuhet në dosjen e tij. Në zhvillimet e shkurtit të vitit 2001, dokumenti i NATO's e përshkruan Ristiçin si jobashkëpunues me ndërkombëtarët dhe si një person të rrezikshëm, por të mbuluar. Ai kishte refuzuar një marrëveshje me KFOR'in. Në qershor të vitit 2001, Sllavisha Ristiç ka organizuar aktivitete të shumta destabilizuese në veri të Kosovës. Ai ka organizuar një tubim të madh të serbëve në veri, kundër aplikimit të taksave të UNMIK'ut për serbët. Në tubimin nxitës të trazirave, bashkë me Sllavisha Ristiçin ishin edhe zyrtarë të tjerë serbë, si Nedelkoviçiqi, Miljentijeviqi, Obradoviçiqi, Boshoviçiqi dhe i ashtuquajturit kryetar i Komitetit të Krizës, Nebojsja Miniçiq. Ai i ka ftuar serbët që në asnjë formë të mos i paguajnë taksa UNMIK'ut dhe është deklaruar haptas edhe kundër PSSP'së, shefit të atëherëshëm të UNMIK'it Hans Hækkerup. „Nëse kjo rezistencë është e pamjaftueshme me protesta, atëherë këtë do ta bëjmë edhe me një luftë të re në Kosovë“, kishte deklaruar Sllavisha Ristiç, citohet në dokumentin konfidencial të NATO's. Sllavisha Ristiç nga UNMIK'u dhe institucionet e Kosovës është konsideruar si Kryetar legjitim i komunës së Zubin Potokut dhe në fund të vitit 2007 atij i është vazhduar mandati i kryetarllëkut në këtë komunë!

<b>KOS</b>	<b>NATO CONFIDENTIAL</b>	Mise à jour le: 04.08.01
<b><u>FICHE BIOGRAPHIQUE</u></b>		
<b><u>IDENTITE</u></b>		
<b><u>NOM :</u></b>	ANTONIJEVIC	
<b><u>Prénom :</u></b>	ALEXANDER	
<b><u>surnom :</u></b>	VUCKO	
<b><u>Date de naissance :</u></b>		
<b><u>Lieu de naissance :</u></b>		
<b><u>Pièce d'identité :</u></b>		
<b><u>Adresse :</u></b>	LEPOSAVIC	
<b><u>Tel :</u></b>		
<b><u>Véhicule :</u></b>	VW PASSAT bleue foncé : KM 417-99	
<b><u>Profession :</u></b>	MEDECIN actuellement à la tête du service de transfusion sanguine à l'hôpital de MITROVICA nord. PRESIDENT DU SNV-NK Adjoint au maire de LEPOSAVIC	
<b><u>COMMENTAIRE :</u></b>		
Membre du comité pour le KOSOVO et METOHIJA (KOSMET), chargé de la santé. Il joue un rôle de tout premier ordre pour la partie Serbe du KOSOVO. Son influence au sein du SNV n'est pas clairement définie, si on sait qu'il y joue un rôle majeur, il apparaît d'avantage comme un homme de l'ombre que comme un tribun.		
<b>Aleksandar Antonijeviq (Leposaviç)</b>		

Në dokumentin konfidencial të KFOR'it është një dosje edhe për **Aleksandar**

**Antonijeviq** nga Leposaviqi, i njohur me nofkën “Vuçko”, njihet si një prej kokave të krimit të organizuar dhe mafisë në veri të Kosovës. Është nënkryetar i kësaj komune dhe me profesion mjek, udhëheqë repartin e Transfuzionit të Gjakut në spitalin në veri të Mitrovicës. Antonijeviq është një kontrollues i mirë i rrjetit mafioz në veri të Mitrovicës dhe një prej krerëve të kontrabandës dhe të krimit të organizuar, i cili edhe ndihmat humanitare, të ndara për serbët e veriut, i ka abuzuar, duke i transferuar në mallra tjera dhe për shitje, duke e shfrytëzuar doganën e Rashkës, shkruan në dokument Ai e ka mbështetur në vazhdimësi grupin mafioz serb të Sllobodan Simonoviçit. “Vuçko” konsiderohet si një prej personave më me ndikim në Këshillin Nacional Serb, ndërsa në rrafshin partiak është Anëtar i DSS’së së V.Koshtunicës dhe si i tillë i ka shërbyer politikës së Beogradit në Kosovë, duke mbajtur lidhje të drejtpëdrejta me Vojislav Koshtunicën. Aleksandar Antonijeviq është i njohur me krimet e bëra gjatë luftës në Bosnjë, saktëson dokumenti. Atje ai e mbante nofkën “Transfuzia”, sepse i kishte mbytur civilët joserbë me tortura të thithjes së gjakut deri në vdekje, saktëson dokmenti i NATO’s. Konsiderohet se të njëjta krime i ka kryer edhe gjatë luftës në Kosovë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, ka bashkëpunuar me Marko Jakshiqin, Oliver Ivanoviçin, Milan Ivanoviçin dhe me liderë të tjerë serbë të veriut, në funksion të trazirave dhe destabilizimit në atë pjesë të Kosovës, saktëson dokumenti. Në dosjen konfidenciale të NATO’s, A.Antonijeviqi “Transfuzia” cilësohet si një kriminel i rrezikshëm për paqen dhe prosperimin politik, jo vetëm në veri të Kosovës.

Référence BIM  
**GAS D**

Mise à jour le : 27.11.01

FICHE BIOGRAPHIQUE

IDENTITE


NOM : MEMAROVIC

prénom : Spasoje

Surnom : ECHO

Date de naissance : 25.02.1950

Lieu de naissance : PEC



**Spasoje Marović - ECHO (25.02.1950)**

Në dokumentin konfidencial të NATO’s, përshkruhet edhe veprimtaria e kriminelit **Spasoje Memarović - ECHO**, i lindur në Pejë me profesion tregtar, ndërsa njihet si ushtarak i vjetër i Armatës Jugosllave. Në dokument Memarović konsiderohet një prej pjesëtarëve të bandave problematike të Mitrovicës Veriore, me “bazë” në kafeterinë famëkeqe “Dolçe Vita”, aty ku u hartuan dhe nisën të gjitha trazirat në Mitrovicën Veriore, prej qershorit të vitit 1999. Spasoje Memarović, me pseudonimin ECHO, ishte gjithashtu një prej firmëzuesve dhe



udhëheqësve të famëkëqinjve “Rojat e Urës” së Ibrit, të njohur, për NATO’ne, si problematikët me “Motorola”. Ai ishte pjesë e armatës së rregullt jugosllave në luftën e Kosovës, dhe nuk u kursye nga krimet mbi shqiptarët. Këtë e ka thënë me krenari edhe në qershor të vitit 1999, shkruan NATO në dokument. Sipas këtij dokumenti, Memarović ka patur lidhje dhe bashkëpunim të ngushtë me politikanë dhe liderë serbë në veri të Kosovës. Prapa tij, në vazhdimësi kanë qëndruar Milan Ivanović, Marko Jakshiq e të tjerë. Shumë prej krimeve në veri, mbajnë autorësinë e tij. Në të gjitha ngjarjet problematike në veri të Mitrovicës, ECHO është prezentë, shpeshherë në gjendje të dehur, por përherë i armatosur dhe i gatshëm për të vrarë. Argumentueshëm thuhet në dokumentet, se ai është përdorur nga politikanët lokalë serbë si nxitës i dhunës në veri, sa herë që iu është dashur atyre. Sipas dokumentit, ai ka qenë personazhi kryesor në konfrontimin e 29 prillit të vitit 2000, në incidentin e njohur të Spitali i Mitrovicës. Spasoje Memarović, i cilësuar si i egri tipik i veriut, ka rekrutuar edhe shumë të rinj serbë në vepra vandale dhe nxitje trazirash, bën të ditur dokumenti konfidencial i NATO’s. Ndër ta, në radhë të parë, e ka rekrutuar djalin e tij 16 vjeçar, të njohur me nofkën “ECHO FOKS”. Bashkë me grupet vandaliste dhe me paramilitarë të shumtë serbë, Spasoje Memarović - ECHO, ka organizuar shumë rrahje të shqiptarëve në veri, me qëllim për t’u shpërngulur dhe sulme të armatosura natën në shtëpitë dhe banesat e shqiptarëve. Shumë incidente dhe krime të ndryshme janë ideuar nga strategu i “Dolçe Vitas”, Spasoje Memarović, në zonat me shqiptarë, veçanërisht të „Tre Rrokaqiejt“ dhe në „Kodrën e Minatorëve“. Dokumenti konfidencial i NATO’së, saktëson se si më 21 qershor të vitit 2000, në mbrëmje, ai kishte sulmuar me armë zjarri familjen shqiptare Baruti. Plumbat e armëve të tij janë gjetur gjatë ekspertizës së sulmit në këtë familje. ECHO ishte bosi i shumë të këqijave që e kishin bazën në kafeterinë famëkeqe “Dolçe Vita”, në veri të Mitrovicës. Ky lokal ishte bërë në fillim të viteve 2000 baza e kriminelëve serbë në veri. Aty gatuheshin politika, trazirat, biznesi i paligjshëm, kontrabanda dhe krimi i organizuar në veri të Mitrovicës, për një kohë të gjatë. “Dolçe Vita”, ishte nyja koordinuese e Rojave të Urës, famëkëqinjve me Motorola, që një kohë të gjatë mbajtën pushtetin e xhunglës matanë urës së Ibrit, me një lidhje të ngushtë me politikanët lokalë të veriut, veçanërisht me kapo-bandën, Milan Ivanović, vegël e të cilit ishte edhe ish’ushtaraku i armatës jugosllave, Spasoje Memarović (ECHO) - thuhet në dokumentin konfidencial të NATO’së.

**KOS - MUP**  
I M I

NATO CONFIDENTIAL

Mise à jour le : 09.09.01

FICHE BIOGRAPHIQUE

IDENTITE

NOM : DELIBASIC

Prénom : DRAGOLJUB alias DRAGAN


surnom : Commandant DRAGAN

Date de naissance : 1957

Lieu de naissance :

Pièce d'identité :

Adresse : DN 8840-4925 -, 19 rue SUTJESICA ( bâtiment TANGO, entrée voisine de celle de Neno MARIC). En compagnie de la journaliste blonde  
Tel : portable: 063 / 801 1610



**Dragan Delibashiq - Kapiten Dragani (1957)**

Në dokumentin konfidencial të NATO's, përshkruhet edhe veprimtaria kriminale e **Dragoljub alias Dragan Delibashiq'it** (1957), i njohur si **Kapiten Dragani** i MUP'it serb në veri të Mitrovicës. Përgjegjësia e mëhershme e Kapiten Draganit në Mitrovicë ka qenë udhëheqës i njësitit të trafikut në policinë serbe dhe ka bashkëpunuar rregullisht me Vuçina Janiqijeviqin, një kapo-bandë tjetër e veriut të Kosovës. Ky i fundit ishte shef i policisë serbe, para luftës në Kosovë, me fushë të përgjegjësisë Zveçanin, Leposaviqin, Zubin-Potokun, Mitrovicën dhe Vushtrinë. Kapiten Dragani, bëhet e ditur në raport, se e ka ndihmuar Vuçina Janiqijeviqin gjatë luftës në Kosovë, në shumë oeracione të tij kundër shqiptarëve, nga baza që e kishte në banesën e paramilitarit serb Sllavko Mandiq, në veri të Mitrovicës. Kishin një komunikim të sofistikuar me "Motorola", në rrjetin e njohur me kodin e kontaktit "Dubnica". Dragani pas vitit 1999 në pjesën veriore të Kosovës ishte koordinator i strukturave të ashtuquajtura të Mbrojtjes Civile të Veriut, pjesë e strukturave të Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme, ndërkaq Zëvendës në përgjegjësinë e tij e kishte Rajko Cekularak - Sekin. Një ndër përgjegjësitë e tij të pasluftës në Kosovën veriore, si pjesëtar civil i policisë serbe në Kosovës, ka qenë përkujdesja për ndërtesat administrative në veri, po që se ato do të merren nga institucionet e Kosovës. Këtë angazhim bëhet e ditur ta ketë kryer në bashkëveprim të ngushtë me Oliver Ivanoviqin. Kapiten Dragani ka patur raporte të mira me Milan Ivanovin, por edhe me Oliver Ivanoviqin. Para luftës në Kosovë ka koordinuar njësi paraushtarake serbe dhe krimet kundër shqiptarëve. Dokumenti e përshkruan Delibashiqin si pjesë aktive e Këshillit Nacional Serb, ku vepron si officer ndërlidhës i strukturave serbe të sigurisë. Në kuadër të veprimtarive të tij destabilizuese në veri të Kosovës, Dragoljub Delibashiq - Kapiten Dragani, përmendet në dokument me një aktivitet të ngjeshur për trazira dhe dhunë në veri të Kosovës, në një periudhë të gjatë kohore, prej majit deri në shtator të vitit 2001 (koha kur ka filluar hartimi i raportit konfidencial të NATO's). Në këtë

periudhë Kapiten Dragani, ka bashkëpunuar ngushtë me SNS'në dhe personalisht me Milan Ivanoviqin, në kryerjen e shumë aksioneve të dhunshme. Ai ka hartuar sulme të armatosura, deri edhe me raketa, kundër shqiptarëve, por edhe kundër anëtarëve të stafit ndërkombëtar në veri të Mitrovicës (UNMIK). Shumë sulme të armatosura dhe trazira në veri, dokumenti konfidencial i NATO's i lidh me emrin e Delibashiqtë dhe të strukturave kriminale rreth tij, me në krye Milan Ivanoviqin. Sipas dokumentit, të gjitha argumentet e nxjerrin Kapiten Draganin një pjesëtar aktiv, me peshë dhe përgjegjësi në hierarkinë e MUP'it serb të paraluftës, gjatë luftës dhe të pasluftës, të implikuar në Kosovë. Ai është një prej emrave më të shquar të menaxhimit të bandave në atë pjesë të Kosovës. Kjo dëshmi tregon qartë për përfshirjen e drejtpërdrejtë të MUP'it serbë në destabilizimin e vazhdueshëm të gjendjes në Kosovë.

<b>KOS</b> <b>MUP</b> 1 M 3	NATO CONFIDENTIAL <b><u>FICHE BIOGRAPHIQUE</u></b>	Mise à jour le : 04.09.01
<b><u>IDENTITE</u></b> <b><u>NOM</u></b> : JANICIEVIC <b><u>prénom</u></b> : VUCINA <b><u>Nationalité</u></b> SERBE <b><u>Fonction</u></b> <b>IL A ETE CHEF DE LA POLICE DE VUCITRN ET DE MITROVICA + FICHE JOINTE</b> <b><u>ORGANISATION POLICIERE</u></b> : <b>- Vuçina Janiçijeviç -</b>		

Në Dokumentin konfidencial të KFOR'it, është përshkruar edhe veprimtaria e kriminelit **Vuçina Janiçijeviç**, banues në Kralevë të Serbisë. Sipas këtij dokumenti ai është përgjegjës direkt për organizimin e strukturave të policisë serbe (MUP) në Kosovë. Vuçina mban lidhje të mira me shumë politikanë serbë të veriut, si dhe ka një bashkëpunim të mirë në veri të Mitrovicës me Dragoljub Delibashiqtë - Kapiten Draganin. Zakonisht, nga Kraleva zbret shpesh në Zveçan, për t'i koordinuar punët dhe aktivitetet e MUP'it serb, thuhet në dokument. Përmes një sistemi mirëfunksional të radiolidhjeve, të ndërtuar në mes të Kralevës dhe Zveçanit, Vuçina Janiçijeviç ka bërë një organizim të rregullt të komunikimit dhe funksionimit të strukturave në MUP'it serb në Kosovë. Dokumenti më tej saktëson se sistemi i komunikimit të "Rojave të Urës" në Mitrovicë, ishte i njëjti me atë të MUP'it serb dhe për këtë përkujdesej Vuçina Janiçijeviç, dhe nga kjo del se, "Rojat e Urës" nuk vepronin të izoluar, por brenda një strukture të mirëorganizuar. Në fund të gushtit të vitit 2001,

derisa Vuçina trajtohej me kancer në Beograd, organizimin e incidenteve te Tre Rrokaqejt, në veri të Mitrovicës do ta organizojë xhaxhai i tij, Mitro Janiçijeviq, ka evidentuar NATO në dokumentin e saj konfidencial.

Edhe në dokumentet konfidenciale të UNMIK'ut, që i janë dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB'së Kofi Annan, shpjegohet gjithanshëm veprimtaria e strukturave paralele serbe në Kosovë, dhe me dëshmi e fotografi të shumta shpërfaqen detaje për vendndodhjen e objekteve të tyre, në të cilat legalisht veprojnë si administratë e qeverisë së Beogradit.

## **VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE PARALELE SERBE NË RAPORTET E MISIONEVE TJERA NË KOSOVË**

Për gjendjen në veri të Kosovës dhe për veprimtarinë gjithëpërfshirëse të strukturave kriminale paralele në Kosovë janë shkruar dhjetra raporte të tjera nga misione të ndryshme që ishin dislokuar në Kosovë pas përfundimit të luftës. Me këtë rast sjellë disa prej tyre:

### **Raporti i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe UNMIK'ut (Tetor 2003)**



**Organization for Security and Co-operation in Europe  
MISSION IN KOSOVO  
Department of Human Rights and Rule of Law**

### **PARALLEL STRUCTURES IN KOSOVO**

*October 2003*

<http://pbosnia.kentlaw.edu/symposium/resources/osce-parallel-structures-2003.pdf>

\* \* \*

**Lexoni**

### **PARALELNE STRUKTURE NA KOSOVU**

<http://www.osce.org/sr/kosovo/42586>

### **Raporti i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) 2006 – 2007**



Organization for Security and Co-operation in Europe  
MISSION IN KOSOVO

Department of Human Rights, Decentralization and Communities

**PARALLEL STRUCTURES IN KOSOVO  
2006-2007**

<http://www.osce.org/kosovo/24618>

\* \* \*

**Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave  
„International Crisis Group“ ICG - 3 qershor 2002  
UNMIK'S KOSOVO ALBATROSS:  
TACKLING DIVISION IN MITROVICA  
3 June 2002**

<http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/Kosovo%2031.pdf>

\* \* \*

**Raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave  
„International Crisis Group“ ICG - 3 qershor 2002  
BRIDGING KOSOVO'S MITROVICA DIVIDE  
Europe Report N°165 - 13 September 2005**

[http://www.aei.org/docLib/20051018\\_ICGReport.pdf](http://www.aei.org/docLib/20051018_ICGReport.pdf)

UNMIK'u ([United Nation Mission in Kosovo](#) - Misioni i Përkohshëm i Administratës së KB) dhe KFOR'i si Mision i [OKB'se](#), për siguri, të vendosur në Kosovë, në bazë të rezolutës 1244, edhe pse këto struktura paralele (siç përshkruhen në raportet e tyre) i kanë cilësuar si organe jolegjitime dhe si të tilla ilegale e kriminale, për çudi i kanë toleruar të vepronjë e të fuqizohen përmes aktiviteteve të tyre politike e kriminale, për më tepër këto misione “paqëruajtëse” siç përshkruhet në raportet e publikuara, edhe kanë bashkëpunuar me këto struktura serbe. Pra, UNMIK'u dhe KFOR'ime këto veprime, përveç se i kanë fuqizuar strukturat paralele serbe, në sytë e opininit serbë, këto struktura i kanë shndërruar në mit. Derisa këto misione ndërkombëtare i toleronin strukturat paralele serbe, Qeveria dhe institucionet tjera të Kosovës luanin rolin e spektatorit. Këto institucione nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim konkret për ta shtrirë sovranitetin dhe rendin kushtetues në këtë pjesë të vendit, madje ato janë treguar skajshmërisht të paaftë për ta shpërfaqur një vizion apo strategji të qartë për verium e Kosovës. Në këtë kuadër, të gjitha qeveritë e Kosovës (nga 2002 -

2011), në vend se të vepronin, gjatë gjithë kohës, kanë preferuar t'i shfrytëzojnë takimet rutinore me UNMIK'un, EULEX'in, zëvendës'sekretarët e shtetit amerikan, zyrtarët e Brukselit dhe konferencat e shtypit për të kërkuar prej tyre që të veprojnë në veri !!!

## **FUNKSIONIMI I MUP'it DHE I STRUKTURAVE TJERA SERBE NË KOSOVË**

“Beogradi po përgatitet, pas ndonjë veprimi të keq të shqiptarëve, për të hedhur forcat e tij në pjesën veriore të Kosovës. Nuk ka njeri që kohët e fundit të ketë qenë në Beograd e që nuk e ka krijuar këtë përshtypje. Nëse amerikanët dhe evropianët nuk ndërmarrin hapa energjikë, druaj se ekziston një përpjekje e re e zgjidhjes së dhunshme të situatës në Kosovë...” - kështu pati deklaruar, më 15 janar 2005, për “Zërin e Amerikës” Daniel Server, drejtor i Iniciativës Ballkanike në Institutin e Paqes në SHBA. Dhe këtë perceptim real të situatës në veri - nga z.Server, duket se e kanë dëshmuar të gjitha zhvillimet e mëvonshme në këtë pjesë të Kosovës. Këtë fakt e përforcojnë edhe më shumë, dislokimet e forcave ushtarake serbe në Kosovën lindore në tetor 2006, që krejt padrejtësisht po thirret Lugina e Preshevës. Pavarësisht nga deklaratimet e përditshme të administratës së UNMIK'ut dhe të institucioneve të Kosovës se, situata në veri të Kosovës është e qetë dhe nën kontroll të plotë, informatat nga terreni tregojnë se, në Mitrovicën veriore dhe në tri komunat tjera në: Leposaviç, Zubin Potok dhe në Zveçan, po veprojnë në forma të kamufluara njësi vullnetare serbe, të organizuara nga Beogradi. Në një koment të botuar më 16 qershor 2006 në gazetën “Epoka e re” thuhet se, “njësitë paraushtarake dhe ushtarake të qeverisë së Serbisë kanë shkelur në territorin e Kosovës dhe e kanë situatën nën kontroll në veri. Disa nga ata qarkullojnë me uniforma të SHPK'së, disa me veshje civile, disa me uniforma të kamufluara.” Në këtë mënyrë, duket se Qeveria e Beogradit ka imponuar shpalljen e “gjendjes së jashtëzakonshme” në tri komunat e veriut të Kosovës dhe prandaj, në këtë frymë sillen edhe të gjithë serbët deri në Urë të Ibrit, ku ndahet jugu prej veriut të Mitrovicës.



**Ndërtesa e MUP'it në Mitrovicën veriore!**

## **Strukturat e MUP'it serbë etj., në veri të Kosovës!**

Pas shpalljes së pavarësisë, veriu i Kosovës ka hyrë në një periudhë të mungesës së plotë të vënies së ligjit dhe rendit kushtetues. Madje, zyrtarët ndërkombëtarë në Prishtinë këtë zonë e kanë cilësuar si një “El Dorado” të Kosovës, dhe kjo gjendje ashiqare është pasojë e një dështimi total të UNMIK'ut, të KFOR'it dhe të institucioneve vendore. Në vend të ndryshimit pozitiv të gjendjes, atje është ruajtur gjendja e status quosë, duke u përqendruar në urën e lumit të Ibrit e cila e ndanë Mitrovicën në dy pjesë. Dihet mirëfilli se, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008, strukturat paralele serbe në veriun e Kosovës u përforcuan me qindra pjesëtarë të Ministrisë së Brendshme të Serbisë - MUP, pastaj nga Sektori policor i Sigurisë Publike dhe departamentet tjera policore, atë të Zbulimit të Shtetit - BIA, të Zbulimit ushtarak VBA e deri te Mbrojtja Civile që kishin ardhur nga Serbia. Selia e udhëheqjes më të lartë të MUP'it dhe BIA's etj., në Mitrovicën veriore gjindet afër lagjes së Boshnjakëve.

Në veri të Kosovës operojnë këta eprorë të lartë të MUP'it serbë:

1. Gjorgje Dragoviç;
2. Ninoslav Mijanoviç;
3. Ivan Aksentijeviç;
4. Sinisha Miliç;
5. Zhivojin Djuriç;
6. Banoviç Sreçko.

Ndërkaq, në veri të vendit - me seli në Mitrovicën veriore vepron edhe Mbrojtja Teritoriale serbe (Teritorialana Odbrana) e cila përbëhet nga:

1. Radisav Janjiqeviç;
2. Bratisllav Stoisavljeviç;
3. Vladan Radovanoviç;
4. Dobrivoje Miliçeviç;
5. Stevan Bozhoviç;
6. Rale Bogdanoviç.

Këto struktura militare e paramilitare që kishin bërë krime gjatë luftës në Kosovë, ishin në krye të të gjitha aktiviteteve kriminale në veri të Kosovës. Këto struktura kriminale, në fillim të shkurtit 2000 morën pjesë në vrasjen e 11 shqiptarëve dhe shpërngulën e mbi 13.000 të tjerëve nga shtëpitë dhe pronat tyre, ishin organizatorë të të gjitha aktiviteteve kriminale në Kosovë, prej prillit të vitit 2002 kur u plagosën 22 policë polakë e deri me 17 mars 2008, kur uorganizua një demonstratë e dhunshme pas uzurpimit të Gjykatës së Qarkut nga gjykatës dhe prokurorë serbë, aty mbeti i vrarë një polic i UNMIK'ut nga Ukraina. Ata ishin të përfshirë edhe në djegien e dy pikave kufitare 1 dhe 31, më 19 shkurt 2008 (vetëm 2 ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës).



**Armë, municione, uniforma dhe pasaporta serbe, të strukturave paralele serbe që veprojnë në Kosovë!**





**Dokumente të identifikimit të agjentëve të sigurimit serbë!**

**Dhuna dhe terrori në Mitrovicë i shkaktuar nga strukturat paralele serbe!**

**Trazira me dhunë në Mitrovicë**

<https://www.youtube.com/watch?v=17ch7PO55nw>

\*\*\*

## **Plani sekret i qeverisë serbe “Aksioni” në veprim!**

Kjo strukturë kriminale, pa u penguar nga askush ka vazhduar aktivitetin e saj konform planit sekret të Qeverisë së Serbisë, të koduar “Aksioni”. Sipas burimeve zyrtare serbe, bojkotimi i organizuar i policëve serbë të SHPK’së, është bërë në përputhje të plotë me porositë e planit sekret “Aksioni”. Ministri për Infrastrukturë i Qeverisë së Serbisë, Velimir Iliq, atëkohë u kishte deklaruar medieve serbe se “ne do të kemi policinë tonë lokale në hapësirat serbe dhe se veprimi i policëve serbë është pjesë e planit aksionar”. Kjo strukturë serbe në veri të Kosovës, ka një infrastrukturë të sofistikuar logjistike të përgjimit nga stacionet e radarëve në Kopaonik, që shtrihet në kufi me Kosovën në një lartësi mbidetare prej 2000 m. dhe vazhdimisht ndihmohet nga qendrat komanduese profesionale të dislokuara në Nish, Rashkë, Novi Pazar, Kraljevë etj. Në këtë kuadër MUP’i serb në Kosovë ka të ndërtuar rrjetin e radiolidhjeve dhe të përgjimit, në bazë të një strukture të fshehtë organizative me qëllim të organizimit të akteve të ndryshme kriminale. Kjo ministri famëkeqe përmes agjentëve të BIA’s dhe grupeve të shumta kanë organizuar një varg aktesh terroriste kundër civilëve, vendbanimeve e automjeteve të serbëve me qëllim që fajin t’ua hedhin shqiptarëve. Në të gjitha enklavat serbe në Kosovë ekziston një ndërlidhje mes tyre që ka dhe mban formën e pushtetit paralel në Kosovë. Nëpër këto baza ka sistem të mirëfilltë të radiolidhjeve, radioamaterëve e sisteme tjera komunikimit. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, shërbimet sekrete serbe,

në shumë pjesë të Kosovës, kanë aktivizuar edhe strukturën e “spiunëve të fjetur”.

### Shikoni e lexoni dokumente të MUP'it serbë që vepron në Kosovë!

РЕПУБЛИКА СРБИЈА  
МИНИСТАРСТВО УНУТРАШЊИХ ПОСЛОВА  
ДИРЕКЦИЈА ПОЛИЦИЈЕ  
Координациона управа за Косово и Метохију  
Полицијска управа за Косовску Митровицу – ИКМ Краљево  
Број 131-308/2007  
12.06.2007. године  
КОСОВСКА МИТРОВИЦА

На основу члана 68. - 75. Закона о раду ("Службени гласник РС", број 24/05 и 61/05), члана 14. Закона о државним службеницима ("Службени гласник РС", бр. 79/05, 81/05, и 83/05) и члана 8. Правилника о раду у Министарству унутрашњих послова 01 број 3245/2002 од 02.10.2002. године, доносим

#### РЕШЕЊЕ

ВУЈИНОВИЋ ЉУБИШИ, раднику Министарства унутрашњих послова, Саобраћајна полицијска испостава 3. категорије /Одељење саобраћајне полиције/ Полицијска управа за Косовску Митровицу/ **КООРДИНАЦИОНА УПРАВА ЗА КОСОВО И МЕТОХИЈУ** одобрава се коришћење годишњег одмора за 2007. годину у трајању од 30 радних дана.

Именовани ће први део годишњег одмора користити у трајању од 15 радних дана у периоду од 07.08.2007. године до 27.08.2007. године, док ће други део користити у трајању од 15 радних дана у периоду од \_\_\_\_\_ године до \_\_\_\_\_ године, а најкасније до 30. јуна 2008. године.


#### Образложење

Дужина годишњег одмора одређена је у складу са Законом о раду, Законом о државним службеницима и одредбом члана 7. Правилника о раду у Министарству унутрашњих послова.

Против овог решења именовани може поднети приговор Жалбеној комисији у року од осам дана од дана уручења решења.

Решење доставити: именованом и у персонални досије.

НАЧЕЛНИК ПОЛИЦИЈСКЕ УПРАВЕ  
главни полицијски саветник  
Драгољуб Делибашић



## ДНЕВНИ ИЗВЕШТАЈ

oј Извештај покрива период од 08:00 часова 17.03.2011 год.  
до 08:00 часова 18.03.2011 год.

Кривична дела: (00)

Решења Јавног Реда и Мира: (00)

Саобраћајне Неводе: (01)

**SAOB. INCIDENT SA MATER. ŠTETOM, SLUČAJ BR. 2011-BA135, UL. KRALJA PETRA, DN: 889-493, SEVERNA POLICIJSKA STANICA - MITROVICA, DANA 17.03.2011 GOD. U 13:40H.**

Dana 17.03.2011 god. U 13:40h Miletić (Vojslev) Vladić, rod. 04.10.1978 god. U Kos. Mitrovici sa prebivalištem u selu Banjska – Vučitrn, br. LK 4464 je prijavio BA-bazi oštećenje na svom vozilu marke Reno Laguna, bele boje sa reg. oznakama KM 324-90 u ul. Kralja Petra kod restorana "Sidro" i čeka na pol. Patrolu kako bi došla na lice mesta.

Na lice mesta odmah je izašla jedna patrola koja je fotografisala oštećenje na vozilu (zadnji levi stop) a žalioc je nakon toga doveden do pol. Stanice radi uzimanja izjave. U izjavi datoj u pol. Stanici oštećeni je naveo da mu je vozilo prethodno bilo parkirano u ul. Kralja Petra br. 147 nakon čega ga je jedan njegov drug Mikić Bato obavestio da mu je jedno sanitetsko vozilo bez reg. oznaka pričinilo pomenutu štetu na vozilu. Po rečima žalioca, pričinjena mu je šteta u vrednosti od 150 Evra. Nakon toga policajci su proverili u bolnici da nema osumnjičenog vozila međutim sumnja se ipak da se radi o sanitetskom vozilu iz neke od enklava.

O svemu je obavešten BA-3 koji je naložio da se slučaj otvori i preda istraž. Jedinici na dalji rad – što je i učinjeno.

Останок: (00)

**INFORMACIJA: POSETA MINISTRA ZA LOKALNU SAMOUPRAVU, UL. OSLOBODENJA, DN: 892-490, SEVERNA POLICIJSKA STANICA - MITROVICA, DANA 17.03.2011 GOD. U 09:30H.**

Dana 17.03.2011 god. u 09:30h u zonu odgovornosti Sev. Pol. stanice tačnije u kancelariju za lokalnu samoupravu i civilne usluge došao je ministar za lokalnu samoupravu Slobodan Petrović. U njegovoj pratnji se nalazila delegacija sa četiri vozila i jedno vozilo reg. saob. jedinice i jedno vozilo iz Reg. Operative.

Poseta ovog ministra je praćena i od strane medija, jednog novinara "PTK" i jedne novinarkе "Radio Kontakt Plus" a na obezbeđenju posete su se nalazile dve patrolе BA-baze iz mešovite jedinice "Community" (BA4 01 BA411).

Poseta je završena u 10:37h nakon čega je pomenuti ministar sa delegacijom praćen do istočnog mosta bez ikakvih problema.

Samo poseta je prošla bez i jednog incidenta a patrolе BA-baze su se vratile svojim redovnim zadacima.

**INFORMACIJA: SPONTANO OKUPLJANJE GRAĐANA, UL. KOLAŠINSKA, DN: 887-487, SEVERNA POLICIJSKA STANICA - MITROVICA, DANA 17.03.2011 GOD. U 11:04H.**

Dana 17.03.2011 god. u 11:04h došlo je do spontanog okupljanja oko 150 građana severnog dela grada Mitrovice u ul. Kolašinskoј kod spomenika "Beli Anđeo" u neposrednoj blizini Glavnog mosta. Povod za ovo okupljanje, kako je doznato sa terena je bio polaganje venaca i cveća u znak sećanja na poginule dana 17. Marta 2004 god. kada su se dogodili nemiri na Kosovu i Metohiji.

Na skupu su govorili načelnik okruga Radenko Nedeljković, predsednik Opštine Krstimir Pantić i jedan član familije od poginulih.

Venci i cveće su polagani na spomenik "Beli Anđeo" kao i na još dve lokacije, na kojima su toga dana poginuli jedan K. Srbin i jedna K. Srпкиnja.

U 11:37h je završeno sa obeležavanjem pomenutog događaja a građani su se mimo razila. Tokom ove manifestacije na obezbeđivanju istog su se nalazile patrolе BA-baze. Nije bilo nikakvih incidenata i sve je prošlo u mirnoj atmosferi.

REPUBLIKA SRBIJA  
MINISTARSTVO UNUTRASNIJH POSLOVA  
Koordinaciona uprava za Kosovo i Metohiju  
Policajska uprava Kosovska Mitrovica  
Broj: \_\_\_\_\_  
Dana 11.02.2009 godine  
KOSOVSKA MITROVICA

POLICIJSKA UPRAVA ZA KOS. MITROVICU  
I K M - K R A L J E V O

**PREDMET: *Zahtev za ostvarivanje prava na sticanje penzije***

Obracam Vam se sa Zahtevom, da mi na osnovu *clana 139, Zakona o Policiji, omogucite pravo na penziju* u okviru zakonskih mogucnosti, od 10. Marta 2009 godine.

Rodjen sam 10.03.1959 godine, tako da sam ispunio poseban uslov u pogledu godina zivota, i navrsio preko 35 godine penzijskog staza, od cega vise od 21 godinu, provedenu na radnim mestima na kojima se staz osiguranja racuna sa uvecanim trajanjem, a u skladu sa propisima o penzijskom i invalidskom osiguranju.

Trenutno sam rasporedjen na random mestu vodja sektora I kategorije, u Stanici saobracajne policije, Policijska uprava za Kosovsku Mitrovicu, sa zvanjem Policijskog narednika.

Iz napred iznetog moze se videti da sam ispunio posebne uslove o sticanju prava na penziju, iz clana 139, zakona o Policiji, pa se nadam da ce te ovaj moj zahtev resiti pozitivno.

PODNOŠILAC ZAHTEVA:  
Policijski Narednik  
VUJINOVIC Ljubisa

## **Grupet kriminale serbe që operojnë në Veri nën omrellën e MUP'it dhe BIA's serbe!**

Gjatë trazirave në veriun e Mitrovicës (2008 - 2010), në pjesë të ndryshme të Kosovës, janë vërejtur edhe pjesëtarë të Njësisë Speciale për Veprime Antiterroriste (SAJ) të Serbisë, sidomos nëpër enklava. Pjesëtarët e kësaj njësie kanë qenë të përqendruar edhe në Kosovën Lindore (Luginën e Preshevës), në pjesën e kufirit me Kosovën dhe me Maqedoninë. Mësohet se, Eprorët e këtij formacioni kriminal kanë pasur kontakte të vazhdueshme me të ashtuquajturat “Shtabe të Mbrojtjes Territoriale”, përkatësisht “Shtabe të Krizës” në veri të Kosovës dhe në enklavat serbe, të cilat në shumicën e rasteve përbëhen nga rezervistë të Ushtrisë Serbe dhe pjesëtarë të JSO'së (njësive për operacione speciale). Disa prej tyre operojnë në kuadër të të ashtuquajturës “Garda e Car Llazarit”, e cila i ka shtrirë celulat e veta në disa pjesë të Kosovës, siç i ka bërë publike në disa komunikata kjo organizatë. Duke pasë parasysh këtë superstrukturë të organizuar kriminale në Kosovë, është i çuditshëm, vendimi i institucioneve të Kosovës për formimin edhe të 14 nënstacioneve të reja policore, 12 prej të cilave në vendbanimet me shumicë serbe. Me këtë projekt brenda strukturave të Policisë së Kosovës, janë futur edhe shumë pjesëtarë të MUP'it serb.

Tashmë dihet mirëfilli se të gjitha grupet kriminale serbe që veprojnë në Kosovë, janë të lidhur me shërbimin sekret BIA dhe MUP'in serb prej të cilëve edhe i marrin direktivat operative. Me këtë rast po i përmendi disa grupe kryesore: Grupet „Car Lazari“, „SNP 1389“, „Nacionalni Stroj“, „Ultra Boys“, „Brdjani“ pastaj Grupi kriminal „Zveçanci“ nga Zveçani, dhe „Mitrovçanci“ nga Mitrovica veriore etj. Grupi „Zveçanci“ vepron në tri grupime më të vogla siç janë: „Canzve Force“, „Elit Delije Sever“ dhe „Extrem Boys“. Në Veri vepron edhe një organizatë kriminale e quajtur „Obraz“ që udhëhiqet nga Igor (Blagota) Vojinoviç. Igori ka lindur në Novi Sad më 28. 04. 1973 dhe banon në Rr. „Rudjer Boskovic“ nr. 7 në Mitrovicë, ku edhe është ligjerues i lendës së historisë në Univerzitetin e Mitrovicës veriore dhe për aktivitete kriminale mbanë lidhje të ngushta edhe me organizatat „1389“ dhe „Car Lazar“ që veprojnë brenda në Serbi.



**Libreza e shefit të organizatës kriminale “Obraz” - Igor Vojinoviç (Srbski Cetnici)**

Në të gjitha këto zhvillime, ishte i përfshirë edhe koloneli Dragan Terziq, i cili zyrtarisht mban postin e këshilltarit policor në Drejtorinë Koordinuese për Kosovën. Siç bëhet e ditur, Terziq komandon me policinë serbe në Kosovë, kurse me “Mbrojtjen Territoriale” komandon koloneli Radisav Janiqjeviq. Nga të dhëna të publikuara me kohë në media, del se në Mitrovicë, në tri-katër vende ka pasur depo armatimi, të dedikuara posaçërisht për këto struktura. Sensibilizimi i situatës për veprimet e lartpërmendura është bërë edhe nga Marko Jakshiq, Kryetar i “Kuvendit të komunave dhe lokaliteteve serbe në Kosovë”, ndërsa Millan Ivanoviqi ishte kryetar i “Këshillit Nacional Serb për Veriun e Kosovës”, njëkohësisht njëri ndër drejtuesit e spitalit regjional në veri të Mitrovicës. Të gjitha këto Struktura kriminale janë prodhues të dhunës dhe destabilitetit në Kosovë.

**Partneriteti i UNMIK’ut me strukturat kriminale serbe në Veri!**

Mësohet se gjatë gjithë kohës, UNMIK'u ka vazhduar të ketë një partneritet të çuditshëm me udhëheqësit e strukturave serbe në veri të Kosovës, duke i konsideruar ata si përfaqësues legjitim të serbëve të Kosovës. Gerard Galluçi, një administrator i UNMIK'ut në Mitrovicë, hapur bashkëpunonte me kriminelët serbë në veri, duke u treguar kështu si një nga figurat më destruktive të UNMIK'ut, dhe duke qenë i tillë - ka penguar çfarëdo nismë për normalizimin e gjendjes në veri. Me këtë rast vlen të theksohet shpërfillja e informatave të inteligjencës, të dhëna nga Selia e UNMIK'ut disa ditë para shpalljes së pavarësisë, mbi synimet e radikalëve serbë për t'i shkatërruar pikat kufitare 1 dhe 31 në Jarinë dhe Bërnjakë. Gerard Galluçi ishte ai i cili parandaloi çfarëdo masash paraprake, duke pohuar që të dhënat e tilla të inteligjencës ishin false, dhe "garantonte" se serbët nuk do të rebelohen. Por, siç dihet, pikat kufitare u dogjën më 19 shkurt 2008, dhe që nga atëherë shërbimi i doganave në veri nuk funksiononte në suazat normale ligjore. Doganat e Kosovës u zhvendosën në jugun e Mitrovicës, dhe kjo ka bërë që të rritet dhe të lulëzojë krimi ekonomik në këtë zonë dhe jashtë saj. Pa dyshim që këto aktivitete kriminale fillonin në Beograd dhe përfundonin në Prishtinë.

Pas shpalljes së pavarësisë, strukturat paralele serbe me përkrahjen e qeverisë serbe dhe ndihmën e shërbimeve sekrete në teren kanë organizuar edhe bojkote ndaj institucioneve të Kosovës, si Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), sistemit gjyqësor të Kosovës, administratës komunale në Mitrovicë, Doganës së Kosovës, Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Hekurudhave të Kosovës.

## **FUNKSIONIMI I GJYKATAVE SERBE NË VERI**



**Gjykata për Kundërvajtje, Gjykata Komunale dhe Gjykata e lartë serbe në Mitrovicën veriore**

Në veri të Kosovës funksionojnë pa u penguar nga askush edhe gjykatat serbe me ligjet dhe Kushtetutën në fuqi të Republikës së Serbisë! Gjykata për kundërvajtje në Mitrovicën veriore (Kosovska Mitrovica) që vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Serbisë dhe që i zbaton ligjet e Serbisë brenda territorit të Republikës së Kosovës punon në këtë adresë: rruga “Nemanjina “ nr. 48, 38220 Mitrovica e Kosovës. Kryetare e kësaj gjykate është Tatjana Virijeviç e cila ka këtë nr.telofoni 028 / 497 -050 dhe palët i pranon çdo ditë nga ora 08:00 - 15:00. (Për më tepër lexoni: [Prekršajni sud u Kosovskoj Mitrovici](#)). Në veri të Kosovës funksionon normalisht, pa u penguar nga askush edhe Gjykata e lartë e Mitrovicës me seli në Zveçan në rrugën “Karadjordjeva p.n” 38224. me numër të telefonit 028-665 103. Kryetar i Gjykatës është Nikola Kabashiç dhe punon çdo ditë nga ora 7:30 - 15:30. (Për më tepër lexoni: [Viši sud u Kosovskoj Mitrovici](#)) Gjykata Komunale e Leposaviqit vepron në adresën: rruga“Nemanjina“ p.n. dhe me nr. telefonit 028/ 835 06. Gjykata për kundërvajtje në Leposaviq në adresën: rruga “Leposaviç Selo“ p.n. dhe me numër të telefonit. 028 / 83223, ndërsa Prokuroria e Mitrovicës selinë e saj e ka në adresën “Kralja Petra I“ nr. 90 dhe nr.tel. 028 / 421- 944.

## **FUQIZIMI I STRUKTURAVE PARALELE SERBE NGA UNMIK’u DHE QEVERIA E KOSOVËS**

Që nga viti 2004 e këndej, pas bojkotimit të zgjedhjeve të Kosovës nga

komuniteti serb, është dëshmuar qartazi se UNMIK'u dhe të gjitha Qeveritë e Kosovës (Rexhepi' Haradinaj' Kosumi' Çeku' Thaçi) janë treguar skajshmërisht të paafte për ta shtrirë pushtetin e tyre në veri të vendit, dhe për pasojë UNMIK'u dhe qeveria e Kosovës gjithnjë kanë marrë vendim, për t'ua zgjatur mandatet kryetarëve të komunave dhe kuvendëve komunale të Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut, të Novobërdës dhe të Shtërpçës, të cilët ndërkohë ishin edhe pjesë e strukturave paralele të Serbisë. Pas zgjedhjeve të vjeshtës së vitit 2007, meqë serbët e veriut i bojkotuan zgjedhjet për herë të dytë, UNMIK'i dhe institucionet e Kosovës (presidenti Fatmir Sejdiu dhe qeveria - Hashim Thaçi) ua zgjatën sërish mandatin kryetarëve të komunave veriore, pikërisht atyre kryetarëve që sot janë në krye të strukturave paralele serbe!



**Slaviša Ristic (i pari nga e majta) Kryetar i Komunës së Zubin Potokut, njeri nga kriminelët e evidentuar në dokumentin sekret të KFOR'it (2001) - tani në barikadën e Rudares, korrik - gusht 2011!**

### **Kush janë ata:**

#### **Slaviša Ristic**

Posti në strukturat paralele: Kryetar i Komunës së Zubin Potokut

Datëlindja 27.10.1964

Unmik ID 1500203214

Vendi i punës Drejtësi - Administratë e gjykatave

#### **Miodrag Andric**

Posti në strukturat paralele Nënkyetar i KK të Zubin Potokut

Datëlindja 01.04.1956

Unmik ID 1501148144

Vendi i punës Administratë: Komunale - Zubin Potok

#### **Nebojša Radulovic**

Posti në strukturat paralele: Nënkyetar i Komunës së Leposaviqit

Datëlindja 18.06.1971

Unmik ID 1501744936

Vendi i punës Administratë Komunale - Leposaviq



**Velimir Bojovic**

Posti në strukturat paralele: Kryetar i Kuvendit Komunal të Leposaviqit

Datëlindja 04.05.1949

Unmik ID 1501558504

Vendi i punës Administratë Komunale - Leposaviq

**Dragiša Milovic**

Posti në strukturat paralele: Kryetar i Komunës së Zveçanit

Datëlindja 04.03.1957

Unmik ID 1501793007

Vendi i punës Administratë Komunale - Zveçan

**Slaviša Staletovic**

Posti në strukturat paralele: Nënkyetar i Komunës së Shtërpcës

Datëlindja

Unmik ID 1501246472

Vendi i punës Administratë Komunale - Shtërpcë

**Bojan Savic**

Posti në strukturat paralele: Kryetar i Kuvendit Komunal të Shtërpcës

Datëlindja 06.02.1981

Unmik ID 1501351861

Vendi i punës SHPK / KPS 6753

**Bojan Cvetkovic**

Posti në strukturat paralele Nënkyetar i Komunës së Novobërdës

Datëlindja 01.02.1973

Unmik ID 1501041668

Vendi i punës Administratë Komunale - Novobërdë

**Dobrosav Ivkovic**

Posti në strukturat paralele: Kryetar i KK të Novobërdës

Datëlindja 30.08.1948

Unmik ID 1501041633

Vendi i punës Arsim - Novobërdë

**Bojan Jovanovic**

Posti në strukturat paralele: Nënkyetar i KK të Novobërdës

Datëlindja 27.09.1973

Unmik ID 1501042443

Vendi i punës Arsim - Novobërdë

Pas shpalljes së Pavarësisë, mosushtrimi i autoritetit kushtetues nga institucionet e Kosovës në raport me strukturat paralele serbe në veri, ka çuar në formimin e mendimit në qarqet diplomatike ndërkombëtare se, autoritetet shtetërore në Prishtinë janë pajtuar me faktin se nuk mund ta kontrollojnë veriun

e Kosovës!!!

## **MBAJTJA E ZGJEDHJEVE SERBE TË MAJIT 2008 NË SHTETIN E PAVARUR TË KOSOVËS**

Republika e Serbisë edhe pas shpalljes së Pavarësisë, ka organizuar zgjedhje në Kosovë. Zgjedhjet e para i ka mbajtur më 11 Maj 2008. Më këtë rast Komisioni Republikan i Zgjedhjeve të Serbisë kishte përgatitur hapur dhe pa u penguar nga organet përkatëse të Republikës së Kosovës, 279 qendra votimi në 23 komuna të Kosovës!!! Mbjtja e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë gjithësesi paraqiste shkelje të drejtpërdrejtë të sovranitetit dhe integritetit territorial, dhe vendin natyrshëm e çonte në drejtim të ndarjes institucionale, etnike dhe territoriale, si dhe njëkohësisht bënte legalizimin dhe fuqizimin e strukturave paralele serbe në veri dhe në disa enklava serbe të krijuara brenda territorit të Republikës së Kosovës. Zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale të organizuara nga Republika e Serbisë në Kosovë me 11 maj 2008, u cilësuan si të paligjshme nga UNMIK'u, Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) etj.



**- Shefi i EULEX'it Yves de Kermabon -**

Madje edhe Misioni i EULEX'it (që u vendos në Kosovë pas Shpalljes së Pavarësisë, si mision për sundimin e ligjit dhe menaxhimin e krizave, bazuar në „COUNCIL JOINT ACTION 2008/124/CFSP of 4 February 2008“ - Lexoni këtu: [http://www.eulex-kosovo.eu/al/info/docs/JointActionEULEX\\_EN.pdf](http://www.eulex-kosovo.eu/al/info/docs/JointActionEULEX_EN.pdf) ) në raport me strukturat paralele serbe, e ka ndjekur të njejtën rrugë si të UNMIK'ut. Shefi i EULEX'it Yves de Kermabon njëri nga ish'komandantët e KFOR'it, që në fillim të misionit të tij kishte deklaruar, se, EULEX'i do të bisedojë e bashkëpunojë me të gjithë, duke i përfshirë edhe strukturat paralele të Serbisë!



**Krimineli Milan Ivanović duke votuar në zgjedhjet e majit 2008**

Më 21 maj 2008 (10 ditë pas zgjedhjeve të 11 Majit 2008 që i mbajti Serbia në Kosovë) Yves de Kermabon, në një intervistë dhënë agjencisë serbe të lajmeve B'92, në pyetjen se a do të bisedonte me serbët e Kosovës të dalë nga zgjedhjet e 11 majit të Serbisë në Kosovë, ka deklaruar (po citoi): "Dëshiroj të flas me gjithsecilin, sepse mendoj që kjo është e vetmja rrugë për të gjetur zgjidhje për serbët që jetojnë këtu". Kermabon me këtë rast, ka bërë të ditur se ai do të jetë i gatshëm të bisedonte me serbët në veri, në çdo kohë kur ata të konsideronin se janë të gatshëm për bisedime! Në fund të kësaj interviste, në pyetjen e gazetarit lidhur me mundësinë e vendosjes së misionit të BE'së në veri, kreu i EULEX'it ka deklaruar (po citoi): "Nuk dua që BE'ja të vendoset me forcë atje. E konsideroj këtë gjë të pamundshme, dhe kjo është arsyeja pse dua të bisedoj me anëtarët e bashkësisë serbe në Kosovë e gjithashtu edhe me autoritetet në Beograd". Dhe, vërtet Yves de Kermabon si përfaqësues i Brukselit shtrirjen dhe praninë e EULEX'it në Kosovën veriore dhe në zonat e tjera serbe e negocioj me Beogradin. Kërkimi i lejes nga Beogradit (pa e pyetur Prishtinën), për vendosjen e EULEX'it në veri të Kosovës dhe në enklavat e banuara me serbë ka sinjalizuar sovranitetin e Serbisë mbi një pjesë të Kosovës. Dhe, me këtë qasje, duket që shefi i EULEX'it - Kermabon ia ka bërë të qartë Serbisë se, EULEX'i si mision i BE'së, do t'i respektoj strukturat e saja paralele në Kosovë!



**Tubimet e serbëve gjatë fushatave zgjedhore në Kosovë!**

Komisioneri i BE'së për Zgjerim, **Olli Rehn** me kohë kishte paralajmëruar se BE do të lejojë serbët e Kosovës të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare

dhe lokale serbe të caktuara për 11 maj. Një paralajmërim të këtillë Rehn e ka bërë më 29 mars 2010, gjatë kohës kur në Bërdo të Sllovenisë po zhvillohej takimi i ministrave të punëve të jashtme të vendeve anëtare të BE'së, ku ndër temat kryesore ishte edhe Ballkani Perëndimor. Rehn duke e arsyetuar qëndrimin e BE'së për këtë çështje, tha se edhe propozimi i Ahtisarit parashikon mundësinë që serbët e Kosovës të kenë lidhje speciale me Serbinë. Ndërkaq duke komentuar deklaratën e kryeministrit, Hashim Thaçi, se politikanët serbë nuk do të votohen më në Kosovë, Rehn tha se është në kontakt permanent me kryeministrin Thaçi dhe se do të rekomandojë që të mos i bëhen obstrukcione këtij procesi. (Telegrafi 29/03/08). Edhe përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian, Javier Solana shprehet për rëndësinë e zgjedhjeve të Serbisë. Gjatë një fjalimi që ka mbajtur Solana në Parlamentin Evropian, ka vënë në pah se "zgjedhjet e 11 majit në Serbi do të jenë të rëndësishme edhe për faktin që për herë të parë do të mbahen në veri të Kosovës". ( BalkanWeb 09/04/08)

### **EDHE INSTITUCIONET E KOSOVËS NDOQËN TË NJEJTËN RRUGË NË RAPORT ME ZGJREDHJET SERBE TË 11 MAJIT NË KOSOVE!**

Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, me këtë rast në vend se të përdorte autoritetin kushtetues, për parandalimin dhe mosmbajtjen e këtyre zgjedhjeve, ai do të kënaqet me deklarin se, „qeveria nuk do t'i njeh zgjedhjet e Serbisë që do të mbahen më 11 maj - në Kosovë“. A kishte kuptim ky qëndrim i kryeministrit Hashim Thaçi?! Në ato rrethana s'kishte asnjë kuptim, i njeh apo nuk i njeh qeveria e Kosovës këto zgjedhje, por kishte kuptim veprimi ligjor, i ndal apo nuk i ndal ato zgjedhje antikushtetuese dhe si të tilla të dëmshme për sovranitetin dhe integritetin e vendit. Për të thelluar edhe më tutje këtë mendim, në esencë nuk ishte problemi tek mosnjohja jonë e atyre zgjedhjeve serbe, por ishte mosnjohja serbe që këto zgjedhje ia bënin sovranitetit të Republikës së Kosovës! Ndërkaq, në një intervistë dhënë Radios Evropa e Lirë, (më 24 prill 2008), Kryeministri Hashim Thaçi ka deklaruar edhe se, zgjedhjet serbe për Kosovën konsiderohen ilegale dhe të papranueshme dhe si të tilla „nuk do të prodhojnë kurrfarë efektesh dhe do të jenë jolegjitime...“!!! (Për më tepër lexoni: [Thaçi - Zgjedhjet serbe në Kosovë ilegale](#))



**- Hashim Thaçi dhe Fatmir Sejdiu -**

Se çfarë efektesh kanë prodhur këto zgjedhje të lejuara nga institucionet e Kosovës, tregojnë ngjarjet e zhvilluara pas 25 korrikut 2011 në veri të Kosovës. Sot këtë pjesë të Republikës së Kosovës e kemi të barikaduar pikërisht nga ato struktura serbe, që dolën nga zgjedhjet e 11 majit 2008!!

Edhe Fatmir Sejdiu (atëkohë president i Kosovës) u mundua ta arsyetojë mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë nëpërmjet të drejtës së dyshtetësisë që serbëve ua mundëson Plani i Ahtisaarit, por, ky ishte një arsyetim i paqëndrueshëm, për faktin sepse nëpër të gjitha vendet e botës ku ekziston dyshtetësia, qytetarët e shtetit X votojnë për zgjedhjet e shtetit Y përmes postës në ambasadën që shteti Y e ka në shtetin X, e në asnjë rrethanë ndryshe. Dhe, kjo ndodh në disa vende. Ta zëmë, meksikanët që kanë shtetësi amerikane lejohen të votojnë në zgjedhjet e Meksikës vetëm nëpërmjet postës apo ambasadës së Meksikës në SHBA. Në të njëjtën mënyrë votojnë edhe kanadezët që kanë shtetësi amerikane etj. Përfundimisht, përveç këtyre deklaratave verbale (sa për sy e faqe!) misionet relevante ndërkombëtare dhe institucionet e Kosovës, nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete në ndalimin e mbajtjes së zgjedhjeve serbe të 11 majit, të cilat legjitimuan dhe fuqizuan Strukturat Paralele në ushtrimin e pushtetit serb, veçanërisht në ato katër komunat veriore (të Leposaviçit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe atë të Mitrovicës veriore).

## **Strukturat paralele të Leposaviqit që dolën nga zgjedhjet e 11 majit 2008**

**([Општин Лепосавић](#))**

## Predsednik opštine

03 avgust 2010



**Branko Ninić, dipl.ing.proiz.menadz.**

Tel. 028 83-860 (sekretarica)

Fax 028 83-139

e-mail. [b.ninic@yahoo.com](mailto:b.ninic@yahoo.com)

**Kryetari i komunës paralele të Leposaviqit është Branko Niniq,**  
Nënkryetar i komunës është Radosh Mihajloviq  
Ndërkaq, Kryetar i Kuvendit të Komunës është Slavko Stevanoviç,  
Nënkryetar i Kuvendit të Komunës është Rato Milojeviç,  
Sekretare e komunës është Jasmina Vukashinoviç.  
Këshillin e Komunës së Leposaviçit e përbëjnë 7 anëtarë :

1. Bojan Ignjatoviç,
2. Ivanka Nedeljkoviç,
3. Vukoje Vukojeviç,
4. Stevica Vidosavljeviç,
5. Branko Sekuliç,
6. Sladjan Radoviç dhe
7. Milan Nikoliç.

**Shikoni foto e tyre:**



**Bojan Ignjatović,**  
dipl.veter.



**Ivanka Nedeljković,**  
spec.opš.medic.



**Vukoje Vukojević,**  
dipl.ing.metal.



**Stevica Vidosavljević,**  
dipl.ing.rudar.



**Branko Sekulić,**  
dipl.ing.tehn.



**Slađan Radović,**  
profesor



**Milan Nikolić,**  
profesor u penziji

### **Ndërsa Asamblenë komunale të Leposaviçit e përbëjnë këta deputetë:**

1. Branko Niniç - Partia Demokratike (DS)
2. Stevica Vidosavljeviç - PD
3. Branimir Vukadinoviç - PD
4. Miloje Vukicevic - PD
5. Zoran Iliç - PD
6. Gordana Jovanoviç - PD
7. Vladimir Lesheviç - PD
8. Zvonko Lukiç - PD
9. Sanja Miladinoviç - PD
10. Ljubisha Milentieviç - PD
11. Rato Milojeviç - PD
12. Sonja Radenkoviç - PD
13. Dragisa Vasiç - Partia Përparimtare e Serbisë
14. Ognjen Vujoviç - PPS
15. Velimir Iliç - PPS
16. Borisa Vuletiv - PPS
17. Dragi Vukiceviç - PPS
18. Velika Arsenijeviç - PPS
19. Ivana Todiç - PPS
20. Goran Lazoviç - PPS
21. Goran Milliceviç - PPS
22. Velimir Bojoviç - PPS
23. Mile Vukojeviç - PPS
24. Rados Mihajloviç - SPS-PUPS-JS-PV
25. Radoje Blagojeviç - SPS-PUPS-JS-PV

26. Slavko Stefanović - SPS-PUPS-JS-PV
27. Milomir Kuzmanović - SPS-PUPS-JS-PV
28. Zoran Milojević - Srbija e Re (NS)
29. Zvonko Perić - SeR (NS)
30. Slavisa Milentijević - Partia Radikale Serbe ( SRS )
31. Dragisa Komatović - PRS (SRS)

Adresa e Komunës është në rrugën “Vojske Jugosllavije“ p.n. Leposaviq 38 218.

(Për më tepër lexoni në faqen: <http://www.leposavic.org/> )

## **Strukturat paralele të Zveçanit që dolën nga zgjedhjet e 11 majit 2008**

Kryetari legjitim i komunës së Zveçanit, me mandat të zgjatur nga Qeveria e Kosovës ishte Dragisha Milloviq, i cili vjen nga Partia DSS e V.Koshtunicës. Pas zgjedhjeve të 11 majit 2008, përkrahja për DSS'në në Zveçan kishte rënë, ndërsa shumicën e votave në këtë komunë i mori Partia Radikale Serbe (SRS) e udhëhequr nga Vojsllav Sheshel, i cili aktualisht është duke u gjykuar në Hagë për krime të luftës. Udhëheqësi i komunës paralele të Zveçanit është Dobrosav Dobriq nga SRS'ja, ndërsa kryetar i komunës së Zveçanit u zgjodh Dragisha Milović i Partisë Demokratike të Serbisë (DSS) të Vojsllav Koshtunicës, pikërisht ai njeri që Qeveria e Kosovës e ka mbajtur në pushtet për disa vjet rresht, duke ja zgjatur mandatin e kryetarit!!! Zëvendës kryetar është Açiç Miodrag i Partisë Socialiste (SPS) të Sllbodan Millosheviçit, ndërsa anëtarët e këshillit të komunës janë:

1. Tomislav Zhivković (SNV),
2. Açiç Vladimir (DSS ),
3. Janjiçijević Milija (SRS),
4. Radovanović Stevan (SRS) dhe
5. Sovrliç Dragan (SRS).

Asamblenë komunale të Zveçanit e përbëjnë këta deputetë:

1. Kryetarë, Dobriç Dobrosav - Partia Radikale e Serbisë
2. Nënkryetar, Radović Lubomir - Këshilli Nacional Serbë
3. Gvozdiç Momçilo - Partia Socialiste e Serbisë
4. Alagiç Velimir - KNS
5. Andjelković Dobrivoje - PRS
6. Vasiç Dushanka - Partia Demokratike e Serbisë
7. Vuksanović Zvezdan - PDS
8. Vuković Radomir - PSS
9. Djokiç Dusan - PDS
10. Ivanović Milan - KNS
11. Jakovljeviç Milan - PDS
12. Jokiç Vitomir - PRS
13. Kostić Ognjan - PDS
14. Miletiç Dragoljub - PRS
15. Milic Ivica - PDS



16. Milosavljević Dragomir - PRS
17. Mitkić Milutin - PRS
18. Mutavdžić Danijela - PRS
19. Miljković Dragica - PDS
20. Petković Stojanka G'17 Plus
21. Radenković Nenad - PDS
22. Radenković Sladjana G'17 Plus
23. Radovanović Petar - PUPS
24. Ristović Nenad - PRS
25. Sofronijević Caslav - PDS
26. Spasojević Nadezda - KNS
27. Filimonović Ratko - PRS

Objekti i Komunës së Zvečanit është në rrugën “Krala Millutina“ p.n. 38227.

Çka shkruhet në portalin e komunës së Zvečanit? <http://www.opstinazvecan.rs/>

\* \* \*



**Një aktivitet i ministrisë: Goran Bogdanoviçit - Ministrit për Kosovë në qeverinë e Serbisë zhvillon mbledhje me strukturat paralele serbe në komunën e Zvečanit:**

**[Посета Министра Богдановића општини Звечан](#)**

Lexoni për Zveçanin në portalin e Ministrisë për Kosovën në qeverinë e Serbisë:

- **[Општина Звечан](#)** -

**Strukturat paralele të Zubin Potokut që dolën nga zgjedhjet e 11 majit 2008**



- Slavisha Ristić -

Kryetar i komunës paralele të Zubin Potokut është Slavisha Ristić (para zgjedhjeve të 11 majit qeveria e Kosovës ia kishte vazhduar mandatin e kryetarit), nënkryetar Srdzan Djurović, ndërsa Kryetar i Kuvendit është Miodrag Andrić. Administrata e Komunës së Zubin Potokut përbëhet nga: Departamenti i çështjeve sociale, Jovan Vlashković; Departamenti për urbanizëm, Vesna Andrić; Departamenti për Ekonomi dhe Financa, Desanka Bozhović; Departamenti për Katastër, Ratomir Bozhović. Objekti i Komunës së Zubin Potokut është në rrugën: “Kolašinsli Kneževa 27; 38228. Komuna e Zubin Potokut (vendlindja e kriminelit Marko Jakshiq) ka vazhduar të jetë një qendër përkrahësish tradicional të orinetimit të DSS dhe strukturave më radikale serbe. Kështu, qeverisja e gjatë me komunën nga kryetari Slavisha Ristić, ka bërë që ai të jetë i pakonteutëshëm në krye të një grupi të interesit që manovron duke kombinuar përkatësinë patriake, nacioanalizmin dhe biznesin. Ristić në Zubin Potok ka ndërtuar sitem klinetalizmi që varësisht nevojave ndërton pozicion nationalist karshi Prishtinës. Shtrirja e liqenit të Gazivodës në këtë hapësirë i ka dhënë edhe më shume rol kësaj komune. (Lexoni: [Општина Зубин Поток](#) )

#### INFORMATORI PËR PUNËN E KOMUNËS - ZUBIN POTOK



### Скупштина општине Зубин Поток

Ул. Колашинских Кнежева 27; 38228 Зубин Поток; Тел, факс - 028 460 068;

#### ИНФОРМАТОР О РАДУ ОПШТИНЕ ЗУБИН ПОТОК

#### ИНФОРМАТОР О РАДУ ОПШТИНЕ ЗУБИН ПОТОК

### **МБАЈТЈА Е ЗГЈЕДНЈЕВЕ ТË РЕПУБЛИКËС СË СЕРБИСË - НË РЕПУБЛИКËН Е КОСОВËС (ГУСНТ 2009 - МАЈ 2010) Згjedhjet serbe të 16 gushtit 2009 - në republikën e Kosovës!**

Republika e Serbisë përveç zgjedhjeve të 11 Majit 2008, në Kosovë ka organizuar edhe zgjedhje tjera, pa u penguar fare nga Qeveria e Kosovës! Në

prill të vitit 2009 me vendim të Qeverisë së Serbisë janë shpërbërë dy komuna paralele: Komuna e „Prishtinës“ dhe ajo e „Pejës“, dhe më 16 gusht të atij viti KQZS’ja serbe organizon zgjedhje të reja për “komunën e Prishtinës” në Graçanicë dhe për “komunën e Pejës” në Gorazhdec. Në këto zgjedhje u shënuan 26.090 votues të regjistruar (!!!), nga të cilët 10,397 në vendbanimet e serbëve të Kosovës në komunën e Prishtinës dhe 15.693 persona të zhvendosur në Serbi!



**Drejtuesit e strukturave paralele në veri: Branko Ninić, Dragiša Milović, Radenko Nedeljković, Slaviša Ristić...**

### **Zgjedhjet serbe të 30 Majit 2010 - në republikën e Kosovës!**

Më 24 dhjetor të vitit 2009 Qeveria e Serbisë kishte marrë vendim për shpërndarjen edhe të dy kuvendeve komunale: të Mitrovicës veriore dhe të Novo Bërdës, dhe i kanë shpallur sipas tyre, zgjedhjet e jashtëzakonshme për këto dy komuna. Ato zgjedhje të jashtëzakonshme do të organizohen më 30 Maj 2010 nga Komisioni Zgjedhor i Sërbisë.

Në garë zgjedhore për Mitrovicën veriore morën pjesë:

1. Partia Përparimtare e Serbisë e Tomisllav Nikoliçit,
2. Partia Demokratike e Serbisë e Vojislav Koshtunicës,
3. Partia Demokratike e Boris Tadiqit,
4. Partia Socialiste e Serbisë e Slobodan Millosheviçit, në krye me Ivica Daçiçin,
5. Iniciativa qytetare „Serbija, Demokracija dhe Drejtësia“ e Oliver Ivanoviçit,
6. G’17 - PLUS e Mladjan Nikiçit,
7. Partia Socialdemokrate e Serbisë së Rasim Ljaiçit,
9. Grupi i Qytetarëve të Këshillit Nacional të Veriut të Kosovës dhe Metohisë në krye me Milan Ivanoviçin.
10. Grupi i Qytetarëve - Shpresa e Re e Mitrovicës e Nebojsa Joviçit,
11. Partia Radikale Serbe e Vojislav Sheshalit,
